



REPUBLIKA E KOSOVES
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE AND TECHNOLOGY
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

UDHËZUES PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTESAVE SHKOLLORE

**UDHËZIMET E
PËRGJITHSHME**

VËLLIMI 1







REPUBLIKA E KOSOVES
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE AND TECHNOLOGY
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

UDHËZUES PËR NORMAT DHE STANDARDET E NDËRTHESAVE SHKOLLORE

**UDHËZIMET E
PËRGJITHSHME**

VËLLIMI 1

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	4

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 11

1.1	MIRËNJOHJE	11
1.2	OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT	11
1.3	SI TË SHFRYTËZOHEN KËTO UDHËZIME	12
1.3.1	PËRKUFIZIMI I PËRGJITHSHËM	12
1.3.2	PËRMBLEDHJA E TEMAVE	12
1.3.3	TREGUESIT REFERUES	12
1.3.4	MODELET (LLOJET) DHE FLETËT E PËRMBLEDHJES TEKNIKE	13
1.4	TERMINOLOGJIA ARSIMORE DHE ARKITEKTONIKE	13
1.4.1	TERMET ARSIMORE	13
1.4.2	TERMET ARKITEKTURALE/TË INXHINIERISË	14
1.5	SISTEMI ARSIMOR NË KOSOVË	14
1.5.1	SIPAS NIVELEVE TË ARSIMIT	14
1.5.2	SIPAS LLOJIT TË SHKOLLËS DHE PËRMBAJTJES	15
1.6	SHFRYTËZUESIT E UDHËZUESIT	16

2. KONCEPTET E PROJEKTIMIT 19

2.1	PËRMBLEDHJA PËR ARKITEKTIN (DETYRA PROJEKTUESE)	19
2.1.1	ORIGJINA DHE STATUSI I PËRMBLEDHJES	19
2.1.2	LOKACIONI	20
2.1.3	LLOJI DHE PLANI I SHKOLLËS	20
2.1.4	MADHËSIA E SHKOLLËS	22
2.1.5	MADHËSIA DHE KAPACITETI I DHOMAVE MËSIMORE	23
2.2	PROGRAMIMI DHE NORMAT E HAPËSIRËS	25
2.2.1	SIPËRFAQET E SHKOLLAVE	26
2.2.2	NORMAT PËR HAPËSIRA PËR SIPËRFAQET E NDËRTUARA	27
2.2.3	HAPËSIRAT E BRENDSHME	27
2.2.4	HAPËSIRAT E JASHTME	27
2.3	PLANET E AKOMODIMIT (SPECIFIKIMI I HAPËSIRAVE)	30
2.4	FUNKSIONALITETI DHE FLEKSIBILITETI	31
2.4.1	FUNKSIONALITETI	31
2.4.2	FLEKSIBILITETI	32
2.5	DIZAJNI DHE ESTETIKA	35
2.6	KOSTOJA DHE PARAMETRAT BUXHETOR	36

3. PARIMET E PËRGJITHSHME

41

3.1	NORMAT TEKNIKE	41
3.2	PARAMETRAT E KOMODITETIT	41
3.2.1	KOMODITETI KLIMATIK (TEMPERATURA)	41
3.2.2	KOMODITETI VIZUAL	47
3.2.3	KOMODITETI AKUSTIK	49
3.3	PROJEKTIMI PËR NJË MJEDIS HIGJENIK	51
3.3.1	HAPËSIRAT E BRENDSHME TË SANITARISË	51
3.3.2	TRAJTIMI I UJËRAVE TË ZEZA DHE ATMOSFERIKE	52
3.4	ELEMENTET TEKNIKE SPECIFIKE	57
3.4.4	NGROHJA	57
3.4.5	AJROSJA	58
3.4.6	UJI I NGROHTË	58
3.5	PROJEKTIMI PËR SIGURI	58
3.5.3	SISTEMET DHE RREGULLAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI	61
3.5.4	SHKATËRRIMI ME KALIMIN E KOHËS DHE FATKEQËSITË NATYRORE	64
3.6	MIRËMBAJTJA	67
3.7	ORENDITË DHE PAJISJET	68
3.7.1	ANTROPOMETRIA DHE DIMENSIONET E ORENDIVË	69
	MESATARJA E GJATËSISË SË NXËNËSVE	70
	REKOMANDIMET PËR MADHËSINË E BANKAVE PËR NXËNËS	70
3.7.2	HAPËSIRA NË RAPORT ME NDËRTIMIN	71
3.8	KËRKESAT E POSAÇME	72

4. SHTOJCAT

79

SHTOJCA 1:	Procesi i Planifikimit të ndërtimit të shkollës
SHTOJCA 2:	Ndërtesat shkollore Planifikimi dhe Programimi
SHTOJCA 3:	Shkollat Standarde
SHTOJCA 4:	Kalkulimi i sipërfaqeve minimale të lokacionit
SHTOJCA 5:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim bazik – viset rurale – 2 cikle (paralele për nivelin arsimor)
SHTOJCA 6:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim bazik – viset rurale – 3 cikle (paralele për nivelin arsimor)
SHTOJCA 7:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim bazik – viset urbane – 3 cikle (paralele për nivelin arsimor)
SHTOJCA 8:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim bazik – viset urbane – 4 cikle (paralele për nivelin arsimor)
SHTOJCA 9:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 3 cikle (paralele)
SHTOJCA 10:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 4 cikle (paralele)
SHTOJCA 11:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 5 cikle (paralele)
SHTOJCA 12:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 6 cikle (paralele)
SHTOJCA 13:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 7 cikle (paralele)
SHTOJCA 14:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 8 cikle (paralele)
SHTOJCA 15:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të ulët – viset urbane – 9 cikle (paralele)
SHTOJCA 16:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të lartë – viset urbane – 7 cikle (paralele)
SHTOJCA 17:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të lartë – viset urbane – 8 cikle (paralele)
SHTOJCA 18:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të lartë – viset urbane – 9 cikle (paralele)
SHTOJCA 19:	Programi i akomodimit të shkollave standarde-Shkolla standarde për arsim e mesëm të lartë – viset urbane – 10 cikle (paralele)

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	6

ANEKSET, TABELAT DHE ILUSTRIMET

- V1-01** Programimi dhe planifikimi i hapësirave shkollore
- V1-02** Procesi i planifikimit të ndërtimit të ndërtesave shkollore
- V1-03** Madhësitë e shkollave standarde
- V1-04** Sipërfaqet minimale të nevojshme për lokacion të ndërtesave shkollore
- V1-05-06** Standardet e shkollave fillore - Programi i akomodimit
- V1-07-10** Standardet e shkollave të arsimit bazik (themelor) - Programi i akomodimeve
- V1-11-20** Standardet e shkollave të mesme të ulëta - Programi i akomodimeve
- V1-21-25** Standardet e shkollave të mesme të larta - Programi i akomodimeve

LISTA E TABELAVE

- 1.1** Indeksi shembull
- 2.1** Madhësia e shkollave (klasëve)
- 2.2** Madhësia e shkollave të arsimit bazik (themelor)
- 2.3** Madhësia e klasëve
- 2.4** Shkollat fillore. Mesatarja bruto e hapësirës për nxënë
- 2.5** Shkollat e arsimit bazik (themelor). Mesatarja bruto e hapësirës për nxënë
- 2.6** Shkollat e mesme të ulëta. Mesatarja bruto e hapësirës për nxënë
- 2.7** Shkollat e mesme të larta. Shpërndarja e lëndëve
- 2.8** Shkollat e mesme të larta. Mesatarja bruto e hapësirës për nxënë
- 2.9** Shkollat fillore. Hapësira minimale për një nxënë
- 2.10** Shkollat e arsimit bazik (themelor). Hapësira minimale për një nxënë
- 2.11** Të mesmet e ultë. Hapësira minimale për një nxënë
- 2.12** Të mesmet e larta. Hapësira minimale për një nxënë
- 3.1** Standardet ISO (Normat e ndërtimit)
- 3.2** Temperaturat minimale të rekomanduara
- 3.3** Mesatarja e faktorëve të reflektimit të dritës
- 3.4** Vlera krahasuese e ndriçimit në Lux

- 3.5** Ndriçimi minimal i rekomanduar
- 3.6** Lloji dhe përdorimi i aparateve kundër zjarrit
- 3.7** Madhësia mesatare e nxënësve
- 3.8** Madhësia e rekomanduar për ulëset e nxënësve
- 3.9** Madhësia e rekomanduar për bankat e nxënësve

LISTA E ILUSTRIMEVE

- 1-2.1** Nivelet e shkollave dhe shpërndarja aktuale e klasave sipas nivelit arsimor
- 1-2.2** Nivelet e shkollave dhe shpërndarja e propozuar e klasave sipas nivelit arsimor
- 1-2.3** Plani i dhomave të zakonshme të mësimit
- 1-2.4** Procesi i projektimit (dizajnit) për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore
- 1-2.5** Programimi (procesi) i ndërtimit të ndërtesave shkollore
- 1-2.6** Shembulli i diagramit funksional për një shkollë të mesme të lartë (1)
- 1-2.7** Shembulli i diagramit funksional për një shkollë të mesme të lartë (2)
- 1-2.8** Metodot e mësimit
- 1-2.9** Vlerësimi i kualitetit të projektit (dizajnit)
- 1-3.1** Skema e zonave klimatike të Kosovës
- 1-3.3** Orientimi i preferuar i dhomave mësimore
- 1-3.4** Komoditeti termik: kryqëzimi i ventilimit
- 1-3.5** Komoditeti termik: mbrojtja nga dielli
- 1-3.6** Komoditeti i dukshmërisë
- 1-3.7** Objektet sanitare me furnizim me ujë dhe kanalizim publik
- 1-3.8** Objektet sanitare me furnizim me ujë pa kanalizim publik
- 1-3.9** Objektet sanitare pa furnizim me ujë
- 1-3.10** Matjet antropometrike
- 1-3.11** Distanca minimale në mes të bankave dhe ulësve
- 1-3.12** Dhomat e zakonshme mësimore. Madhësia e orendive të kategorisë C
- 1-3.13** Dimensionet e karrocave (plani)
- 1-3.14** Dimensionet e karrocave (profillet)

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

MMK	Madhësi Mesatare e Klasës
KKTV	Këshill për Kurrikulum, Tekste Shkollore dhe Vlerësim
VCD	Vlerësimi i Cilësisë së Dizajnit
EMIS	Sistem Informativ për Menaxhimin e Arsimit
PMM	Plan për Menaxhimin Mjedisor
BE	Bashkim Evropian
NPD	Nivel i Përfunduar i Dyshemesë
SIGj	Sistem Informativ Gjeografik
P	Kati përdhes
P+1	Kati përdhes plus një kat
SPG /GPS	Sistem i Pozicionimit Global
DI	Departament i Infrastrukturës
IDEP	Projekt për Zhvillimin Institucional të Arsimit
IDA	Agjenci Ndërkombëtare për Zhvillim/International Development Agency
GKA	Grant Komunal për Zhvillimin e Arsimit
DKA	Drejtori Komunale e Arsimit
MMPH	Ministri e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
MASHT	Ministri e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OzhEB	Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim
PNM	Proporcion Nxënës – Mësimdhënës
RED	Departament Rajonal i Arsimit
DSO	Dokumentet Standarde për Ofertim
GZhSh	Grant për Zhvillim të Shkollës
TeR	Termet e Referencës
UNMIK	Mision i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
AAP	Arsim dhe Aftësim Profesional


Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	8

KODET TREGUESE

NIVELET E ARSIMIT:

AP	Arsimi Parafillor
AF	Arsimi Fillor
AB	Arsimi Bazik (themelor)
APF	Arsimi Parafillor dhe Fillor
AMU	Arsimi i Mesëm i Ulët
AML	Arsimi i Mesëm i Lartë
AMU/L	Arsimi i Mesëm i Ulët dhe i Lartë
GJN	Të gjitha nivelet

LLOJI I SPECIFIKIMIT		KODI	NORMA APO SPECIFIKIMI
0	Referencat	REF	Listat e shtojcave, tabelave, shifrave, shkurtesave
1	Hyrje	HYR	
2	Konceptet e projekteve	KP	Programimi i hapësirave Projektimi i hapësirave Mundësia për qasje
3	Parimet e përgjithshme (Vëllimi 1)	PP	Normat teknike Siguria dhe parrezikshmëria Parametrat e komoditetit Orenditë dhe pajisjet
4	Parametrat specifik (Vëllimi 2)	PS	Lidhur me tiparet dhe kufizimet e lokacionit Lidhur me mjedisin Lidhur me klimën
5	Udhëzimet për hapësirat e brendshme (Vëllimi 2)	HB	Hapësirat e mësimdhënies Hapësirat e administratës Hapësirat shtesë
6	Udhëzimet për hapësirat e jashtme (Vëllimi 2)	HJ	Fushat e lojës dhe strehët e hapura Hapësirat për lojë Shtigjet, rrugët, parkingu, hapësirat e gjelbëruara





1. HYRJE

1.1 PARATHËNIE

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5, pika 7.1 ka hartuar Udhëzuesin për normat dhe standardet për hapësirat shkollore. Ky udhëzues është hartuar nga Departamenti i Infrastrukturës, gjegjësisht nga nga një ekip i profesionistëve që janë pjesë e stafit të këtij departamenti si dhe është mbështetur nga konsulentët ndërkombëtarë dhe vendorë të projektit IDEP të Bankës Botërore.

Ekipi gjithashtu ka punuar ngushtë me departamentet tjera të MASHT-it, të cilët kanë dhënë udhëzime të vlefshme gjatë përgatitjes së këtij dokumenti. Gjithashtu, gjatë procesit të hartimit të këtij udhëzuesi janë mbajtur diskutime publike me institucionet e nivelit lokal e qendror, si dhe me organizatat tjera profesionale.

Udhëzuesi është hartuar në dy vëllime. Në vëllimin e parë janë përfshirë udhëzimet e përgjithshme, ndërsa në vëllimin e dytë udhëzimet specifike. Financimi i studimit dhe përgatitja e Udhëzuesit janë realizuar në kuadër të projektit IDEP, përmes grantit të Bankës Botërore."

1.2 OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT

Ky dokument ka për qëllim që të shërbejë si referencë për projektuesit e shkollave dhe të ndërtësive shkollore. Dokumenti përcakton dhe përshkruan hapësirat e nevojshme arsimore sipas llojit, madhësisë dhe specifikimeve në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga MASHT-i për shkollat publike në viset urbane dhe ato rurale të Kosovës.

Këto udhëzime do të bëjnë që të krijohet një kup-tim jo vetëm rreth hapësirave të nevojshme fizike shkollore, por edhe rreth faktorëve që ndikojnë në projektimin e tyre dhe cilësinë e mjedisit që duhet të arrihet brenda dhe rreth ndërtësive.

Udhëzimet përfshijnë të dhënat rreth të gjitha llojeve të hapësirave shkollore: hapësirave akademike, siç janë dhomat e zakonshme mësimore dhe laboratorët, hapësirat përcjellëse, siç janë bibliotekat, hapësirat administrative dhe hapësirat e jashtme për aktivitete, si hapësirat për lojë, fushat sportive, qasja dhe parkimi. Këto udhëzime mund të përdoren për qëllime të ndryshme dhe për nivele të ndryshme, duke përfshirë:

- Projektimin e shkollave të reja;
- Projektimin e zgjerimeve të shkollave ekzistuese;
- Vlerësimin dhe përmirësimin e hapësirave (lokacioneve) dhe shkollave ekzistuese;
- Studimin e orendive dhe pajisjeve shkollore, si dhe furnizimin me to;
- Bazën referuese për studime rreth shfrytëzimit dhe efikasitetit të ndërtësive.

Përveç kësaj, këto udhëzime japin rekomandime, për nivelet më të larta dhe më të ulëta, rreth projektimit të hapësirave të mësimdhënies dhe atyre përcjellëse të ndërtësive shkollore, duke marrë parasysh nevojën për praktikabilitet, përshtatshmëri dhe fleksibilitet në të ardhmen, efikasitetin në kosto, dhe kështu synojnë që të japin kontribut thelbësor për projektimin e mirë të ndërtësive shkollore.

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	12

1.3 SI TË SHFRYTËZOHEN KËTO UDHËZIME

1.3.1 PËRKUFIZIMI I PËRGJITHSHËM

Për arsye praktike, është vendosur që udhëzuesit të ndahen në dy vëllime (doracak), ku i pari është dedikuar për Udhëzimet e Përgjithshme ndërsa i dyti për Udhëzimet Specifike. Kjo ndarje nënkupton përsëritjen e elementeve të përbashkëta sidomos të atyre në lidhje me specifikimet dhe konceptet e përgjithshme.

Përgatitja e normave, specifikimeve dhe udhëzimeve të këtyre doracakëve është bazuar në të dhënat e mëposhtme:

- Udhëzimet ekzistuese për shkollat fillore të Kosovës, të cilët tashmë përdoren si dokumente referuese nga planifikuesit, projektuesit dhe mbikëqyrësit e zonave të punës;
- Ligji për arsimin i MASHT-it;
- Normat ISO për ndërtimtari;
- Ligjet e tjera të Kosovës, duke përfshirë Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për planifikimin hapësinor dhe rregulloret për mbrojtje nga zjarri; Ligjin e ndërtimit; Udhëzimi për Kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar; Rregullore teknike për kursimin e energjisë termike dhe mbrojtjen termike në ndërtesa;
- Kurrikulumi i ri për arsimin e përgjithshëm;
- Projekte të ndryshme standarde për ndërtimin e shkollave në Kosovë dhe
- Udhëzime të tjera të përgatitura paraprakisht nga konsulenti.

Standardet dhe udhëzimet e paraqitura në këta doracakë duhet të respektohen dhe shërbejnë si rekomandime që mund të modifikohen për t'iu përshtatur kushteve specifike, siç janë dimensionet e hapësirave dhe topografia apo mundësitë e zgjerimit të shkollës.

Gjithashtu, skicat dhe vizatimet e hapësirave tipike mësimore të përfshira në këto udhëzime nuk kanë për qëllim të kufizojnë projektuesit nga ofrimi i alternativave dhe i zgjidhjeve të tjera për forma (dimensione dhe sipërfaqe) dhe rregullime të këtyre hapësirave mësimore në kuadër të kërkesave të njëjta.

1.3.2 PËRMBLEDHJA E TEMAVE

Përmbajtja e udhëzimeve është e ndarë në dy kategori të specifikimeve: (i) konceptet e përgjithshme dhe ato specifike, parametrat dhe normat, dhe (ii) përmbledhjet teknike me modele dhe udhëzime për çdo lloj hapësire dhe për hapësirat e jashtme. Kjo ndarje i mundëson lexuesit që të mbledhë informacione në dy nivele:

(i) Të dhënat dhe udhëzimet e përgjithshme të paraqitura në kapitujt 2 dhe 3 në vëllimin e parë :

- Konceptet e projektimit;
- Normat e përgjithshme;

(ii) Karakteristikat specifike, modelet e detajuara , të dhënat dhe udhëzimet në kapitujt 1 deri në 5 në vëllimin e dytë:

- Parametrat specifik
- Udhëzimet dhe modelet për hapësirat e brendshme
- Udhëzimet dhe modelet për hapësirat e jashtme

1.3.3 TREGUESIT REFERUES

Treguesit referues janë të vendosur në këndin e sipërm në anën e majtë të çdo faqeje për të lehtësuar gjetjen e temave pa pasur nevojë t'i referoheni tabelës së përmbajtjes. Këta tregues tregojnë nistoret e nivelit të arsimit dhe të temës (shih më lart listën e shkurtesave) në rendin si në vijim:

- Kutia e parë: niveli përkatës i arsimit (APF, AF, AMU, AML ose GjN);
- Kutia e dytë: Lloji i specifikimit (nistoret e normave, parametrave ose hapësirave);
- Kutia e tretë: Numri i faqes ose numri identifikues i përmbledhjes teknike.

Kodet treguese janë shpjeguar në pjesën “shkurtesat dhe akronimet” në faqen 2. Si shembull, treguesi i tabelës 1.1 më poshtë i referohet arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë, në lidhje me “parametrat specifike”, faqe 12

TABELA 1.1
SHEMBULL I TREGUESIT

Cikli	Tema	Faqe
AMU/L	PS	12

Tabelat në tekst dhe në shtojca kanë ngjyra të ndryshme, ku secila prej tyre korrespondon me një nivel të ndryshëm të arsimit: ngjyra e kaltër për nivelin fillor, e verdha për nivelin e mesëm të ulët, ngjyra e portokalltë për nivelin e mesëm të lartë dhe e gjelbra për temat që kanë të bëjnë me nivele të ndryshme.

1.3.4 MODELET (LLOJET) DHE FLETËT E PËRMBLEDHJES TEKNIKE

Në çdo fletë të përmbledhjes teknike paraqiten të gjitha normat, parametrat dhe elementet e nevojshme për hapësirat e brendshme duke përfshirë:

- Dimensionet dhe sipërfaqet që korrespondojnë me ato të planeve të akomodimit;
- Kërkesat për hapësira dhe aktivitete;
- Lidhjet me hapësirat e tjera shkollore dhe qasjet e nevojshme;
- Lista e pajisjeve të fiksuara me propozime për instalim/lokacion dhe
- Kërkesat për hapësirë dhe skema funksionale.

Ky dokument do të përditësohet kohë pas kohe për të

pasqyruar politikat e reja apo të korrigjuara dhe kërkesat e parashtruara nga MASht-i.

1.4 TERMINOLOGJIA ARSIMORE DHE ARKITEKTONIKE

Fjalorthi i përdorur nga autoritetet, specialistët e arsimit dhe teknikët e sektorit publik dhe privat përfshinë terma që nuk mund të kenë kuptimin e njëjtë për të gjithë. Këto udhëzime përdorin terme që përdoren në përgjithësi nga stafi i MASht-it. Këto janë:

1.4.1 TERMET ARSIMORE

- **ARSIMI BAZIK (THEMELOR):** Klasat nga 0/1 deri 9 (grupmosha: 5/6 deri 15 vjet);
- **KLASË:** Grup i nxënësve që mësojnë në nivelin e njëjtë akademik. Në sistemin rotativ klasa nuk korrespondon me dhomën e mësimi.
- **SHKOLLAT GJITHËPËRFSHIRËSE:** Shkollë që përfshinë arsimin e përgjithshëm dhe profesional.
- **DHOMË MËSIMI E PËRGJITHSHME:** Hapësirë e projektuar dhe e pajisur për mësim të të gjitha lëndëve të nxënësve.
- **KLASA:** Niveli i studimeve arsimor, që i referohet periudhës kohore prej një viti shkollore.
- **ARSIMI BAZIK:** Përfshinë Nivelin Parafillor dhe atë Fillor. Niveli parafillor: klasa 0, mosha 5-6 vjeç, Fillor: klasa 1-5, (grupmosha 6-12) që iu përgjigjen “ndërtesave” të shkollës fillore.
- **ARSIMI I MESËM I LARTË:** Klasat 10 deri në 12 (grupmoshat 15 deri 19 vjeç) Ky nivel i përgjigjet “ndërtesave të shkollave të mesme të larta”
- **LABORATOR:** Hapësirë e projektuar dhe e pajisur ku nxënësit kryejnë eksperimente të mbikëqyruara nga lëndët e biologjisë, kimisë, dhe fizikës, individualisht ose në grupe.

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	14

- **ARSIMI I MESËM I ULËT:** përfshinë klasat 6-9 (grupmosha 12-15) Ky nivel i përgjigjet ndërtësive shkollë të "Arsimit të mesëm të ulët"
- **HAPËSIRA PËR QËLLIME TË SHUMËFISHTA:** Hapësirë e projektuar dhe e pajisur për të akomoduar aktivitete të ndryshme arsimore dhe sociale të organizuara, siç janë mbledhjet, diskutimet grupore, ekspozitat, shfaqjet, ligjëratat, etj
- **ARSIMI PARAFILLOR:** klasa 0 (grupmoshat: fëmijët 5 dhe 6 vjeç) Ky nivel i përgjigjet "ndërtësive" para-fillore.
- **SHKOLLAT RURALE:** Shkollat që gjendet në komunitete të vogla (qyteza ose fshatra) që kanë më pak se 10.000 banorë.
- **SIPËRFAQJA E LOKACIONIT:** Një term që paraqet madhësinë e pronës së ndërtësive arsimore. Ka dallim mes zonave urbane dhe rurale.
- **SHKOLLË URBANE:** Shkollë që gjendet në një zonë të qytetës apo qytetit që ka më shumë se 10.000 banorë.
- **ARSIMI PROFESIONAL DHE TEKNIK:** Programe arsimore ku nxënësve u mësohen lëndët profesionale, siç janë bujqësia, ekonomia shtëpiake, industria, biznesi.

1.4.2 TERMET ARKITEKTURALE/TË INXHINIERISË

- **KOMODITETI AKUSTIK:** Kushtet akustike në të cilat shkolla dhe shfrytëzuesit e saj mund të veprojnë me efikasitetin maksimal.
- **HAPËSIRAT ADMINISTRATIVE:** Hapësirë fizike e shkollës e dedikuar për aktivitete administrative.
- **HAPËSIRAT E QARKULLIMIT:** Hapësirë e caktuar për qarkullimin horizontal dhe vertikal brenda ndërtësës, si hollët e hyrjes, korridoret dhe shkallët.
- **KOMODITETI KLIMATIK:** Kushtet mjedisore në të cilat shkolla dhe shfrytëzuesit e saj mund të veprojnë me efikasitetin maksimal.

• **HAPËSIRAT ARSIMORE:** Hapësira fizike e shkollës e cila i dedikohet aktiviteteve edukative.

• **MJEDISI HIGJENIK:** Kushtet e përgjithshme të higjienës në shkollë që ndikojnë në nivelin e komoditetit dhe shëndetin e shfrytëzuesve dhe varen nga kushtet fizike të ndërtësive sanitare, furnizimi me ujë, rezervat e ujit dhe sistemi i largimit dhe trajtimit të ujërave të zeza të cilat mundësojnë që ndërtesa shkollë të funksionon në mënyrë efikase dhe të sigurt.

• **ORIENTIMI:** Orientimi i ndërtësës shkollë (pjesa e hapësirave arsimore), që ndikohet nga faktorët natyrorë klimatikë, si dielli dhe drejtimi i erës.

• **LOKACIONI I NDËRTESËS SHKOLLORE:** Sipërfaqja e tokës brenda së cilës janë të vendosura ndërtësat arsimore.

• **HAPËSIRAT NDIHMËSE:** Hapësirat fizike në ndërtësë shkollë të dedikuara për mbështetje të aktiviteteve arsimore dhe ato administrative.

1.5 SISTEMI ARSIMOR NË KOSOVË

1.5.1 SIPAS NIVELEVE TË ARSIMIT

Ligjit të Arsimit Parauniversitar (nr. 04/L-032), sistemi arsimor në Kosovë është i ndarë në katër nivele kryesore të arsimit:

- Niveli 0: **Niveli parafillor:** 1 vit për fëmijët e grupmoshës 5 deri 6 vjeç;
- Niveli 1: **Arsimi fillor** (faza e parë e arsimit themelor) për 5 vite (mosha 6 deri 12);
- Niveli 2: **Arsimi i mesëm i ulët** (faza e dytë e arsimit themelor) për 4 vite (mosha 12 deri 15)
- Niveli 3: **Arsimi i mesëm i lartë** për 3 ose 4 vite, varësisht nga kurrikulumet (mosha 15 deri 19). Ky nivel, i hapur për nxënës në baza vullnetare, ka katër drejtime kryesore: gjuhët, shkencat shoqërore, matematika dhe komunikimi, shkencat natyrore etj.

Në Kosovë, arsimit obligativ nga klasa e parë deri në të nëntën (arsimi bazik/themelor) dhe ndërtesat shkollore në përgjithësi janë në dispozicion për këto klasa edhe pse (i) madhësitë e tyre shpeshherë janë shumë të vogla për numrin e nxënësve, gjë që detyron MASHT-in që në shumë shkolla të organizojë mësim në dy apo tri ndërrime, (ii) vendndodhja e tyre nganjëherë është në distanca të papërshtatshme nga fshatrat, veçanërisht shkollat amë, (iii) klasat e specializuara të mësimit shumë shpesh mungojnë për nivelet e mesme, dhe (iv) shumë ndërtesa shkollore janë në kushte jo të mira fizike.

Në zonat rurale me popullatë të shpërndarë, sistemi i arsimit zhvillohet në **paralele të shkollave** (niveli fillor me klasat 1 deri 5) dhe shkollat amë të vendosura nëpër fshatra me një pozitë qendrore (arsimi bazik/themelor, klasat 1 deri 9), ku nxënësit e paraleleve të shkollave mund të ndjekin arsimin në klasë më të larta.

1.5.2 SIPAS LLOJIT TË SHKOLLËS DHE PËRMBAJTJES

Kufizimet dhe problemet më të rëndësishme të sistemit arsimor të Kosovës lidhen me mungesën e ndërtësive dhe të infrastrukturës: shumë shkolla nuk i posedojnë ndërtesat që korrespondojnë me kurrikulumet e MASHT-it, ku si rezultat mësimdhënësit japin vetëm mësim teorik dhe, për shkak të numrit të shumë të nxënësve shumë shkolla punojnë me ndërrime të shumëfishta.

Për të trajtuar çështjet më të rëndësishme të sektorit, MASHT-i ka hartuar një "Strategji për zhvillimin e arsimit parauniversitar" (2007-2017), me shtatë objektiva kryesore. Një nga këto objektiva është sigurimi i «një mjedisi fizik të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimnxënie dhe mësimdhënie» përmes krijimit të kushteve për projekte/dizajne efikase dhe të përsh-

tatshme të ndërtësive shkollore dhe zvogëlimit të ndërrimeve të shumëfishta.

Kjo që u tha është përfshirë edhe në strategjinë 2011/2016.

Këto udhëzime janë pjesë e hapave të parë drejt përmirësimit të përgjithshëm të mjedisit fizik të arsimit. Udhëzimet propozojnë një rishikim të plotë të nevojave për ndërtesa shkollore, në bazë të kurrikulumit, fondit javor të orëve mësimore dhe numrit të të regjistruarve. Sipas këtyre skemave të reja, ndërtesat shkollore duhet t'i kenë hapësirat e mëposhtme:

- (i) Shkollat e **arsimit fillor**: Ndërtesa për nivelin e arsimit fillor përbëhet nga hapësirat e mësimit, siç janë dhomat mësimore, biblioteka, hapësira për qëllime të shumëfishta, salla e kompjuterëve dhe hapësirat përcjellëse, që përfshijnë zonat administrative dhe ato të shërbimeve (përcjellëse teknike). Përveç kësaj, **niveli parafillor** i arsimit duhet të ketë dhoma mësimore, hapësira për lojë dhe tarraca në ambient të hapur;
- (ii) Shkollat e **arsimit të mesëm të ulët**: Ndërtesa për nivelin e arsimit të mesëm të ulët përbëhet nga hapësirat kryesore të arsimit, siç janë dhomat mësimore, biblioteka, hapësira për qëllime të shumëfishta, laborator i përgjithshëm për shkencë (biologji, kimi dhe fizikë), salla e kompjuterëve dhe hapësirat përcjellëse që përfshijnë zonat administrative dhe ato të shërbimeve (përcjellëse teknike) dhe
- (iii) Shkollat e **arsimit të mesëm të lartë**: Ndërtesa për nivelin e arsimit të mesëm të lartë përbëhet nga hapësirat e njëjta si të nivelit të mesëm të ulët përveç numrit shtesë të lëndëve të specializuara. Mësimdhënia është e organizuar në katër drejtime kryesore ku përfshihet matematika dhe teknologjia informative, gjuhët, shkencat shoqërore dhe shkencat natyrore.
- (iv) **Arsimi bazik/themelor**. Shkollat që ofrojnë arsimin

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	16

për nivelin 0 deri 9 (parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët), do të mbeten të njëjta por me disa modifikime: propozohet që për ndërtesat shkollore të reja, të dy nivelet e Shkollave të Arsimit Bazik të vendosen në të njëjtin lokacion por në ndërtesa (hapësira) të ndryshme, në përjashtim të hapësirave që mund të shfrytëzohen nga të dy nivelet (fillor dhe i mesëm i ulët) siç janë: administrata, hapësira për qëllime të shumëfishta, biblioteka, kantina, halla për sport dhe hapësirat të shërbimeve (përcjellëse teknike). Përveç kësaj, dizajni i këtyre ndërtesave shkollore do të bëhet në atë mënyrë që në të ardhmen këto shkolla të bashkuara të mund të ndahen dhe të bëhen tërësisht të ndara me ndryshime minimale në zgjerim dhe ndryshime në ndërtesa.

- (v) Për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të ulur presionin mbi nxënësit dhe mësuesit, MASht është pajtuar që në shkollat e reja të mos punohet në më shumë se dy ndërrime dhe se sistemi aktual i ndërrimeve do të modifikohet në mënyrë që nxënësit e të dyja niveleve të zhvillojnë mësimin në ndërtesat/hapësirat e dedikuara për secilin nivel (lloji i ndërtesave/hapësirave dhe madhësia e inventarit për secilin nivel ka madhësi të ndryshme). Ky propozim mund të jetë më i vështirë për menaxhimin e orareve të mësuesve, por është i paevitueshëm nëse synohet përmirësimi i kushteve për mësim dhe rehati për nxënësit.

sektorit publik, ato duhet të përdoren edhe nga sektori i arsimit privat. Këtu përfshihen:

- (i) Të gjithë profesionistët që kanë të bëjnë me projektimin/dizajnimin dhe ndërtimin e ndërtesave shkollore, duke përfshirë: organizatat profesionale projektuese, kompanitë konsulente, arkitektët, inxhinierët, si dhe profesionistët e tjerë të projektimit dhe ndërtimit;
- (ii) MASht-i, administrata komunale me drejtoritë përkatëse, administratat e tjera publike apo private, drejtorët e shkollave, këshilli administrativ, administratorët dhe mësuesit. Këto udhëzime gjithashtu përbëjnë një dokument referues për studimet teknike dhe/apo të kërkimeve të ndërlidhura me shkollat e MASht-it.

1.6 SHFRYTËZUESIT E UDHËZUESIT

Ky dokument ka për qëllim që të shërbejë si udhëzues referues për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programeve, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të shkollave apo në renovimin e ndërtesave ekzistuese shkollore. Ndonëse këto udhëzime janë hartuar për shkollat e

2



2. KONCEPTET E PROJEKTIMIT

2.1 PËRMBLEDHJA PËR ARKITEKTIN (DETYRA PROJEKTUESE)

Kjo pjesë e udhëzuesit paraqet renditjen e aktiviteteve që do të kërkohen të kryhen nga ekipi projektues. Pas kontratës formale për punët e projektimit, aktivitetet fillojnë me nxjerrjen e një përmbledhjeje për ekipin, e cila përmban adresën e lokacionit dhe dokumentin me përmbledhje të informatave. Ekipi nuk ka kontroll paraprak mbi përmbajtjen e përmbledhjes, e cila përgatitet pas një shqyrtimi të duhur nga faktorët përkatës të departamentit përkatës të komunës apo nga Departamenti i infrastrukturës i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Kjo procedurë zbatohet edhe nëse ekipi i projektimit është firmë e pavarur konsulente ose ekip i profesionistëve nga komuna apo MASHT-i.

2.1.1 ORIGJINA DHE STATUSI I PËRMBLEDHJES

Përmbledhja përbën pikën e fillimit të punës së ekipit të projektimit. Përgatitja e saj duhet të bëhet mbi këto baza:

- Përshkrimi i një dite të zakonshme të shkollës në këtë moment dhe se si do të ndryshojë ajo me agjendën transformuese;
- Struktura organizative e shkollës, përfshirë menaxhmentin, departamentet, mbështetjen këshilluese joformale dhe kështu me radhë;
- Etikën dhe vlerat e shkollës;
- Aktivitetet që do të vendosen në shkollë, duke përfshirë edhe jashtë orarit për nevojat e komunitetit si

dhe llojin e aktiviteteve që kërkohen;

- Shpeshtësinë e aktiviteteve të ndryshme - nivelet e përdorimit të llojeve të ndryshme të akomodimit;
- Afërsinë e kërkuar në mes të aktiviteteve të ndryshme, departamenteve etj;
- Aranzhimet për qasjen e komunitetit dhe nivelet e duhura të sigurisë;
- Mënyrat sipas së cilave shkolla mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt, në llogari të ndryshimeve pedagogjike, organizimeve joformale këshilluese dhe metodave të reja të mësimdhënies.

Të gjitha këto informata janë shumë të dobishme për projektuesit/dizajnerët e shkollës prandaj duhet të përfshihet në përmbledhje të detajuara si informata.

Pasi të jenë zgjedhur të gjitha këto çështje, faza tjetër e hartimit të përmbledhjes është përpilimi i detajuar i planit të akomodimit/detyrës projektuese (fleta që liston të gjitha hapësirat e nevojshme). Kjo detyrë projektuese (plani i akomodimit) do të listojë saktësisht numrin e klasësve të duhura dhe madhësitë minimale të dhomave mësimore të tyre, si dhe kapacitetin e parashikuar të shkollës të dhënë më termat e numrit të përgjithshëm të vendeve të nxënësve dhe grupeve. Informata të mëtejshme lidhur me dhomat e veçanta janë të listuara në atë që zakonisht njihet si fleta me të dhëna për të gjitha llojet e dhomave mësimore. Detyra do të shtohet deri në një sipërfaqe të përgjithshme në të cilën synohet të bëhet ndërtimi në mënyrë që të sigurojë që limitet financiare të mos jenë tejkaluar.

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	20

2.1.2 LOKACIONI

Caktimi i lokacionit për një shkollë të re propozohet nga komuna pas vendimit nga drejtoria e saj përkatëse për planifikim të infrastrukturës shkollore bazuar në nevojat e arsimit (planifikimi i shkollave duke u bazuar në “rrjetin e shkollave”) dhe disponueshmëria e tokës bazuar në planet rregulluese të komunës miratohet nga MASHT-i duke u bazuar në strategjitë dhe politikat e zhvillimit të infrastrukturës shkollore në nivel kombëtar. Vlerësimi i alternativave dhe përzgjedhja përfundimtare e lokacionit bazohet edhe në kriteret e miratuara së bashku me projektuesit. Kjo përzgjedhje kërkon kërkime dhe studime rreth aspekteve dhe kriterëve të mëposhtme:

Nevojat arsimore të zonës që mbulohet nga shkolla me kërkesat potenciale për regjistrim;

- Disponueshmëria e tokës së përshtatshme;
- Lagjja dhe relacioni me zonën e banuar;
- Madhësia e shkollës në krahasim me normën e autorizuar të shfrytëzimit;
- Disponueshmëria e shërbimeve komunale (ujë, rrymë, kanalizim, telefon);
- Karakteristikat topografike dhe përshtatshmëria për ndërtesa shkollore;
- Karakteristikat gjeodezike dhe implikimet e mundshme në shpenzimet e themelimit;
- Planifikimin dhe rregulloret e rregullat e qytetit;
- Përfshirjen e komunitetit (bashkësia lokale) dhe interesimi i saj për projektin.

Pasi të jetë përzgjedhur lokacioni përmes një procesi zyrtar, ekipit të projektimit do t'i jepen rezultatet e kërkesave të lartcekura me adresën dhe të dhënat e mjaftueshme. Më shumë për detaje rreth parametrave tjerë specifik të lokacionit përshkruhen në kapitullin 1 të Vëllimit 2 të udhëzuesit.

2.1.3 LLOJI DHE PLANI I SHKOLLËS

Deri më sot, dhomat mësimore kanë qenë të madhësive të ndryshme, duke filluar nga 24 deri në 40 vende për nxënës, varësisht nga projektuesit dhe financuesit e ndryshëm. Për një standardizim më të mirë të dhomave mësimore dhe për t'iu përgjigjur më mirë gjendjes aktuale të vendit, është është paraqitur e nevojshme që shkollat e reja do të përcaktohen si «**zona urbane apo zona me dendësi të lartë të popullsisë**» ose «**zona rurale apo zona me dendësi të ulët të popullsisë**» dhe kjo, për shkak të madhësive të ndryshme të grupeve të nxënësve apo të klasave të nxënësve (24 në zonat rurale dhe 30-36 në zonat urbane), do të ketë ndikim mbi standardet e hapësirës dhe madhësive të dhomave mësimore që duhet të miratohen nga projektuesit. Ky përcaktim do të bëhet nga MASHT-i përmes Departamenteve përkatëse, në bazë të popullsisë aktuale dhe të ardhshme të zonës përkatëse që e mbulon shkolla.

Shkolla do të përkufizohet sipas llojit apo nivelit arsimor, pra ai parafillor, fillor, themelor, i mesëm i ulët apo i mesëm i lartë së bashku me vargun e klasave që duhet të vendosen, siç përshkruhet më poshtë. Lloji i shkollës dhe vargu i klasave do të zgjidhen nga Departamenti arsimi në komunë në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e zonës së mbulueshmërisë së shkollës.

Deri më sot, shumica e shkollave në Kosovë kanë qenë të ndara në tri lloje:

- Shkollat e arsimit bazik (themelor)** që përfshijnë nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët (klasa 0 deri 9);
- Paralelet e shkollave të arsimit fillor** me një numër më të vogël të nxënësve (klasa 1 deri 5), me ose pa klasa për arsimin parafillor, që në përgjithësi kanë qenë të vendosura në zonat me dendësi të ulët të popullsisë dhe që i referohen shkollës amë për klasat më të larta të nivelit të mesëm të ulët dhe
- Shkollat e arsimit të mesëm të lartë** (klasat 10 deri 12).

Kjo gjendje pritet që me kalimin e kohës të kalojë në

Shkollat dhe shpërndarja e klasëve sipas nivelit arsimor-gjendja aktuale




FIG. 1-2.1

Shkollat dhe shpërndarja e klasëve sipas nivelit arsimor -e propozuar




FIG 1-2.2

■ MADHËSIA E SHKOLLAVE (KLASAT E NXËNËSVE)

Ciklet e plota	Zonat urbane me densitet të lartë				Zonat rurale me densitet të ulët		
	Parafillor	Fillor	M. i ulët	M. i lartë	Parafillor	Fillor	M. i ulët
VITET:	1	5	4	3	1	5	4
					PARALELET E NDARA		
1					1	5	
2					2	10	8
	SHKOLLAT AMË				SHKOLLAT AMË		
3	3	15			3	15	12
4	4	20			4	20	16
5	5	25	20		5	25	20
6	6	30	24	18			
7			28	21			
8			32	24			
9			36	27			
10				30			
11				33			

TABELA 2.1

një sistem të dyfishtë me (i) shkolla të posaçme për secilin nivel të arsimit në zonat me popullsi të densitetit të lartë (kryesisht në vendet urbane) dhe (ii) me sistemin aktual të paraleleve të shkollave dhe shkollave amë të arsimit bazik (themelor) për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët në zonat me popullsi të densitetit të ulët.

2.1.4 MADHËSIA E SHKOLLËS

Madhësia e shkollës zakonisht përcaktohet nga (i) numri i nxënësve të regjistruar (numri aktual dhe ai i planifikuar i nxënësve) dhe (ii) metoda e zgjedhur për menaxhimin e hapësirës dhe mësimdhënies. Objektivat për regjistrime përcaktohen nga departamentet e planifikimit dhe projektimit të shkollave, ndërsa mënyra e menaxhimit të hapësirës dhe mësimdhënies zakonisht varet nga vendimet e marra

nga administratat komunale/rajonale apo ato të shkollave.

Ekzistojnë dy metoda të menaxhimit të hapësirës dhe të mësimdhënies, varësisht nga mënyra e shfrytëzimit të klasave të mësimi:

(i) **Shfrytëzimi i fiksuar i klasave** është kur një klasë nxënësish (grup nxënësish) caktohet në një dhomë mësimore dhe mësimdhënësit e lëndëve të ndryshme shkojnë nëpër dhomat mësimore për të dhënë mësim, dhe/apo nxënësit lëvizin nëpër dhomat e specializuara të mësimi, duke lënë dhomën e tyre të zakonshme të mësimi bosh. Për shkak të presionit të rëndë demografik (numri i lartë i nxënësve edhe deri në tre ndërrime) dhe mungesës së dromëve të specializuara të mësimi të mbushura me pajisje, ky sistem është më i zakonshmi që përdoret në Kosovë.

(ii) **Sistemi rotativ i mësimdhënies** ku pas çdo ore

mësimore nxënësit lëvizin dhe shkojnë në dhomat mësimore të përcaktuara për lëndë të caktuar, si p.sh. për gjeografinë, gjuhën, shkencat etj. Ky sistem është më ekonomik dhe kërkon më pak dhoma të mësimi. Ai gjithashtu ka edhe përparësi të tjera, siç janë ekspozimi i përhershëm i mjeteve didaktike të lëndës të dedikuara për atë dhomë mësimi apo laborator. Këto udhëzime e rekomandojnë këtë sistem dhe i bazojnë llogaritjet e madhësisë së shkollës për nivelet e arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë në këtë teori.

Bazuar në përvoja madhësia minimale dhe ajo maksimale e shkollave të reja standarde janë përcaktuar (Vëllimi 1, shtojca 03 dhe tabelat 2.1 dhe 2.2 më poshtë) si në vijim: (i) paralelet e shkollave parafillore dhe fillore: 1 dhe 2 cikle të plota (6 dhe 12 klasë nxënësish), (ii) shkollat parafillore dhe fillore: 3 deri 6 cikle të plota (15 deri 30 klasë nxënësish), (iii) shkollat e mesme të ulëta: 2 deri 10 cikle (8 deri 36 klasa nxënësish), dhe (iv) shkollat e mesme të larta: 4 deri 12 cikle (12 deri 33 klasa nxënësish).

Për shkollat a arsimit bazik (themelor) (niveli parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët), madhësia standarde është: (i) në zonat rurale, 2 dhe 3 cikle të plota (20 dhe 30 klasë nxënësish); dhe (ii) në zonat gjysmë urbane, 3 dhe 4 cikle (30 dhe 40 klasë nxënësish).

■ MADHËSIA E SHKOLLAVE TË ARSIMIT BAZIK (THEMELOR) (KLASAT E NXËNËSVE)

Ciklet e plota	Parafillor	Fillor	M. i ulët	Gjithsej
Vitet:	1	5	4	
Zonat rurale me densitet të ulët				
2	2	10	8	20
3	3	15	12	30
Zonat urbane me densitet të lartë				
3	3	15	12	30
4	4	20	16	40

TABELA 2.2

Vendimet për madhësinë minimale dhe maksimale të shkollave shpijnë në gjithsej 29 shkolla standarde prej të cilave 19 janë për zonat urbane apo për ato me popullsi me dendësi të lartë, dhe 10 për zonat rurale apo për ato me dendësi të ulët, (shihni tabelën 2.3 më poshtë).

2.1.5 MADHËSIA DHE KAPACITETI I DHOMAVE MËSIMORE

Madhësia dhe sipërfaqja e dhomave mësimore janë planifikuar në përputhje me (i) numrin e paraparë të ulëseve të nxënësve (kapacitetet); (ii) përmasat dhe llojin e bankave dhe karrigeve në lidhje me moshën dhe madhësinë e nxënësve; (iii) numrin e rreshtave ballorë dhe numrin e bankave dhe karrigeve në një rresht ballor kur klasa është e organizuar sipas modelit klasik, (iv) distancën e pranueshme minimale dhe maksimale prej nxënësve deri tek dërrasa e shkrimit, mjetet vizuale apo ekrani, si dhe këndi i pranueshëm minimal i pamjes; (v) hapësirën minimale për një qarkullim të lehtë mes bankave dhe karrigeve dhe për një mësimdhënie të mundshme nga çdo pikë; (vi) largësinë e pranueshme minimale mes nxënësve; (vii) sipërfaqen e mjaftueshme dhe dimensionet që mundësojnë vendosjen e orendive në mënyra të ndryshme në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të punojnë vet, në grupe të vogla ose në tërësi; dhe (viii) kërkesat e veçanta për nxënësit me aftësi të zvogëluara të lëvizjes dhe/ose me nevojë të veçanta arsimore.

Përveç kësaj, projektuesi duhet të bëjë vlerësimin dhe të kuptojë se si ligjërohet kurrikulumi dhe se si do të shfrytëzohen klasat e mësimi në mënyrë që ai të mund të del me zgjidhje të reja për llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen në klasat e mësimi. Ai gjithashtu duhet të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë ndërveprimin dhe qasjen në hapësirat e tjera, siç janë (i) hapësirat përcjellëse që ju përshtaten nxënësve me angazhime tjera, (ii) zonat depove dhe ato për mbështetje të mësimdhënësve, (iii) vendet për ruajtjen e rrobave dhe çantave të nxënësve.



FIG.1-2.3

nësve; (iv) hapësirat sociale dhe rekreative.

Për të lehtësuar procesin e planifikimit dhe të projektimit të shkollave, MASHT-i ka vendosur që të gjitha klasat e reja të mësimi do të kenë një kapacitet prej (i) tridhjetë deri tridhjetë e gjashtë vendeve të nxënësve në zonat me popullsi të dendësisë të lartë (kryesisht ato urbane), (ii) njëzetë e katër vendeve të nxënësve në zonat me popullsi të dendësisë së ulët (kryesisht zonat rurale), (iii) të katër nivelet e arsimit do të kenë kapacitete të njëjta për të gjitha klasat e tyre të mësimi, dhe (iv) punët praktike në laboratorë dhe salla të specializuara do të mësohen në grupe të përgjysmuara me 15-18 ose 12 nxënës

MADHËSIA E DHOMAVE MËSIMORE PROPOZIMET MINIMALE

Niveli i arsimit	Vende për nxënësit		Sipërfaqja në M2		M2/vend të nxënësit	
	Ulët	Lartë	Ulët	Lartë	Ulët	Lartë
Dendësia e popullsisë						
Parafillor	24	30-36	48	65	2.0	1.8-2.2
Fillor	24	30-36	44	58	1.8	1.6-1.9
Mesëm i ulët	24	30-36	45	58	1.9	1.6-1.9
Mesëm i lartë	24	30-36	nuk ka	58	nuk ka	1.6-1.9

TABELA 2.3

Shkollat dhe shpërndarja e klasëve sipas nivelit arsimor-gjendja aktuale




FIG.1.2.4

Sipërfaqet mesatare të dhomave mësimore radhiten prej 44 deri në 48 m² për shkollat në zona me popullsi të dendësisë së ulët me klasë të nxënësve prej 24 vetave dhe prej 58 deri në 65 m² në zonat me popullsi të dendësisë së lartë me klasë të nxënësve prej 30-36 vetave (shihni tabelën 2.3 më lartë). Këto dimensionime janë llogaritur në bazë të kapaciteteve të kërkuara (24 dhe 30-36 nxënës), numrit dhe përmasave të bankave në rreshtat ballorë (3 banka të dyfishta) si dhe në rreshtat gjatësorë (shihni modelet e dhomave mësimore në figurën 1-2.3 më poshtë).

2.2 PROGRAMIMI DHE NORMAT E HAPËSIRËS

Në procesin e planifikimit të ndërtesave shkollore, procesi i dizajnit të normave dhe i standardeve i përket fazës së dytë të procesit të planifikimit të ndërtesave shkollore që përfshinë një cikël prej katër aktiviteteve të ndryshme (Vëllimi 1, shtojcat 01 dhe 02). Kjo fazë e dytë, e quajtur "Kërkimi dhe zhvillimi" përfshinë përgatitjen e normave dhe standardeve të ndryshme për projektim/dizajn të ndërtesave shkollore dhe përgatitjen e prototipave të orarit të akomodimit të shkollës.

Procesi I planifikimit të ndërtimit të shkollave




FIG.1-2.5

2.2.1 SIPËRFAQET E SHKOLLAVE

Ndërtesat shkollore janë të ndara në tri kategori kryesore, në mënyrë që të mundësohet llogaritja e sipërfaqes mesatare për nxënës për secilën kategori dhe për të lehtësuar krahasimin me projektet e tjera të shkollave në Kosovë dhe/apo në shtetet e tjera. Këto tri kategori kanë të bëjnë me:

- Hapësirat për mësim me hapësirat e tyre përcjellëse

të dedikuara për secilin nivel të arsimit;

- Hapësirat për administratë;
- Hapësirat përcjellëse të përbashkëta dhe ato shtesë për shërbime që i caktohen shkollës si tërësi.

2.2.2 NORMAT PËR HAPËSIRA PËR SIPËRFAQET E NDËRTUARA

Sipërfaqet e rekomanduara për zonat e mësimdhënies dhe ato të mbështetjes pedagogjike bazohen në kapacitetet e kërkuara, dimensionet e orendive, gjerësinë e qarkullimeve të brendshme dhe llojin e aktiviteteve. Sipërfaqet e hapësirave llogariten në bazë të numrit të shfrytëzuesve dhe llojit të aktivitetit që kryhet në ato ndërtesa. Sipërfaqet e hapësirave të qarkullimit janë llogaritur si përqindje e sipërfaqeve të hapësirave të ërcaktuara për aktivitete (mes 21 dhe 25%).

2.2.3 HAPËSIRAT E BRENDSHME

Vlerësimi i nevojave për hapësira për mësimdhënie dhe mbështetje edukative vlerësohet në bazë të kurrikulumit, fondit javor të orëve mësimore, përqindjes së shfrytëzimit dhe kapacitetit të dhomave (shih para. 2.3 mbi planet e akomodimit më poshtë).

Dhomat/zyrat e administratës dhe të shërbimeve përcaktohen sipas numrit të shfrytëzuesve dhe funksioneve të tyre.

Numri i tualeteve dhe hapësirave të tjera sanitare përcaktohet në proporcion me kapacitetin e përgjithshëm të shkollës (për shembull, për një tualet llogaritet një mesatare prej 30 nxënës)

Pas rekomandimeve të lartcekura për llogaritjen e numrit të nevojshëm të hapësirave dhe sipërfaqes, janë përgatitur 27 plane (orare) të akomodimit të hapësirave për secilin nivel të arsimit dhe secilën madhësi të shkollës. Analiza e këtyre planeve jep sipërfaqen neto dhe bruto për çdo nxënës për secilën kategori të hapësirës dhe për sipërfaqen e përgjithshme të tërë shkollës standarde. Sasitë dhe sipërfaqet e detajuara janë paraqitur në Vëllimin 1, shtojcat 06 deri 09 dhe janë paraqitur si përmbledhje në tabelat 2.4 deri 2.8 më poshtë. Për pesë shkollat standarde të nivelit të mesëm të lartë, nevojat e hapësirave

janë kalkuluar në bazë të shpërndarjes teorike të katër grupeve të propozuara, siç janë dhënë në tabelën 2.7 më poshtë.

2.2.4 HAPËSIRAT E JASHTME

Hapësirat e jashtme ndahen në tri kategori:

- Hapësirat e caktuara për zona të rekreacionit (fushat e lojës) dhe zona për sport;
- Zonat e qarkullimit përfshirë ato për automjete (rrugët dhe parkingun) dhe për këmbësorë (trotualet dhe shtigjet);
- Zonat e gjelbra dhe ato të mbjella me drunj, kaçube, shkurre, si dhe lëndinat.

Kërkesa minimale e sipërfaqes së tokës për çdo lloj të shkollës llogaritet duke shtuar hapësirat e jashtme të nevojshme për sipërfaqet e ndërtuara të çdo ndërtëse. Kjo sipërfaqe varet nga kapaciteti i shkollës, numri i kateve, dhe proporcioni i parallogaritur i tokës për sipërfaqe të mbjella dhe hapësira të qarkullimit. Llogaritja e detajuar e kërkesave për tokë për çdo standard të shkollës është dhënë në Vëllimin 1, shtojca 04 dhe është përmbledhur në tabelat 2.9 deri në 2.12 më poshtë.

■ SHKOLLAT FILLORE

SIPËRFAQJA BRUTO MESATARE NË M²/PËR NXËNËS

Grupimi i Hapësirave sipas funksionit	6 KL	12 KL	18 KLCL	24 KL	18 KL	24 KL	36 KL CL	36
Dendësia e popullsisë	Dendësia e ulët (Viset rurale)			Dendësia e lartë (Viset urbane)				
Mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike (parafillore)	6.89	6.07	6.39	7.66	4.94	5.16	5.22	5.12
Mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike (fillore)	3.86	3.39	5.04	4.99	4.28	4.10	3.98	3.86
Ndërtesat opsionale	0.00	0.23	0.27	0.90	0.03	0.51	0.67	0.56
Gjithsej përfshirë qarkullimin pa ndërt. Opsionale	4.37	3.84	5.27	5.43	4.39	4.28	4.19	4.07
Gjithsej përfshirë qarkullimin me ndërt. Opsionale	nuk ka	4.07	5.54	6.33	4.42	4.79	4.86	4.63

TABELA 2.4

■ SHKOLLAT E ARSIMIT BAZIK (THEMELOR)

SIPËRFAQJA BRUTO MESATARE NË M²/PËR NXËNËS

Grupimi i Hapësirave sipas funksionit	20 KL	30 KL	30 KL	40 KL
Dendësia e popullsisë	Dendësia e ulët (Viset rurale)		Dendësia e lartë (Viset urbane)	
Mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike (parafillore)	5.14	4.82	4.16	4.24
Mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike (fillore)	3.48	3.43	3.82	3.80
Mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike (e mesme e ulët)	11.56	10.75	7.21	6.90
Administrata	0.56	0.44	0.29	0.22
Shërbimet e përbashkëta	0.98	0.91	0.87	0.85
Gjithsej përfshirë qarkullimin	8.42	7.85	6.37	6.16

TABELA 2.5

■ SHKOLLAT E MESME TË ULËTA

SIPËRFAQJA BRUTO MESATARE NË M2 /PËR NXËNËS

GRUPIMI I HAPËSIRAVE SIPAS FUNKSIONIT	12 CL.	16 CL.	20 CL.	20 CL.	24 CL.	28 CL.	32 CL.
DENDËSIA E POPULLSISË	DENDËSIA E ULËT (VISET RURALE)			DENDËSIA E LARTË (VISET UR- BANE)			
Mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike	5.70	5.33	4.71	6.26	5.42	4.95	5.13
Administrata	0.68	0.52	0.45	0.48	0.44	0.40	0.38
Shërbimet e përbashkëta	0.67	0.63	0.62	0.89	0.87	0.87	0.86
Gjithsej përfshirë qarkullimin	7.05	6.49	5.77	7.63	6.73	6.22	6.36

TABELA 2.6

■ SHKOLLAT E MESME TË LARTA – GRUPIMI I LËNDËVE

GRUPIMI I LËNDËVE	GRUPIMET	CIKLET					KLASAT				
TOTAL CIKLET		7	8	9	10	11	7	8	9	10	11
Gjuhët	A	2	2	2	2	3	6	6	6	6	9
Shkencat shoqërore	B	1	2	2	2	2	3	6	6	6	6
Matematika dhe Informatika	C	2	2	3	3	3	6	6	9	9	9
Shkencat natyrore	D	2	2	2	3	3	6	6	6	9	9

TABELA 2.7

■ SHKOLLAT E MESME TË LARTA

SIPËRFAQJA BRUTO MESATARE NË M2 /PËR NXËNËS

Hapësirat funksionale	21 KL.	24 KL.	27 KL.	30 KL.	33 KL.
Hapësira për mësim dhe mbështetje pedagogjike	4.93	4.37	4.64	5.47	5.41
Hapësira për Administratë	0.47	0.44	0.41	0.38	0.35
Hapësirat plotësuese	0.95	0.93	0.92	0.89	0.89
Totali me përfshirje të hapësirave të komunikimit (qarkul- luese)	6.35	5.73	5.97	6.74	6.65

TABELA 2.8

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	30

■ ARSIMI FILLOR

SIPËRFAQJA MINIMALE E LOKACIONIT PËR KOKË NXËNËSI

(m²/i për nxënës)

Madhësia e shkollës	Dendësia e Popullsisë	Numri i kateve		
		P	P+1	P+2
6 klasë të nxënësve	E ulët	10.9	-	-
12 klasë të nxënësve	E ulët	10.3	-	-
18 klasë të nxënësve	E ulët	10.9	-	-
18 klasë të nxënësve	E ulët	-	8.3	-
24 klasë të nxënësve	E ulët	9.9	-	-
24 klasë të nxënësve	E ulët	-	7.7	-
18 klasë të nxënësve	E lartë	9.9	0.0	-
18 klasë të nxënësve	E lartë	-	7.6	-
24 klasë të nxënësve	E lartë	-	7.5	-
30 klasë të nxënësve	E lartë	-	7.1	-
36 klasë të nxënësve	E lartë	-	6.4	-
36 klasë të nxënësve	E lartë	-	-	5.7

■ ARSIMI I MESËM I ULËT

SIPËRFAQJA MINIMALE E LOKACIONIT PËR KOKË NXËNËSI

(m²/i për nxënës)

MADHËSIA E SHKOLLËS	DENDËSIA E POPULLSISË	NUMRI I KATEVE		
		P	P+1	P+2
12 klasë të nxënësve	E ulët	16.2	-	-
16 klasë të nxënësve	E ulët	14.7	11.4	-
20 klasë të nxënësve	E ulët	11.4	9.3	8.2
20 klasë të nxënësve	E lartë	12.0	9.6	8.3
24 klasë të nxënësve	E lartë	10.7	8.5	7.4
28 klasë të nxënësve	E lartë	9.4	7.9	7.0
32 klasë të nxënësve	E lartë	9.5	8.0	7.0
36 klasë të nxënësve	E lartë			

TABELA 2.9

■ ARSIMI I MESËM I LARTË

SIPËRFAQJA MINIMALE E LOKACIONIT PËR KOKË NXËNËSI

(m² / për nxënës)

Madhësia e shkollës	Densiteti i Popullsisë	Numri i kateve		
		P	P+1	P+2
21 klasë të nxënësve	E lartë	11.5	9.8	-
24 klasë të nxënësve	E lartë	10.6	8.9	7.9
27 klasë të nxënësve	E lartë	10.1	8.2	7.2
30 klasë të nxënësve	E lartë	9.3	7.5	6.5
33 klasë të nxënësve	E lartë	8.9	7.3	6.4

TABELA 3.5

2.3 PLANET E AKOMODIMIT (SPECIFIKIMI I HAPËSIRAVE)

2.3.1 SHKOLLAT FILLORE - STANDARDE

Programi për 12 lloje shkollash parafillore dhe fillore standarde është ndërtuar me ndihmën e tabelave Excel, që paraqesin planet standarde të akomodimit nëpër hapësirat e shkollave me densitet të ulët apo shkollave në zonat rurale (24 nxënës për klasë), dhe për shkollat më densitet të lartë apo shkollave në zonat urbane (30-36 nxënës për klasë). Kjo tabelë paraqet për secilin standard listën e dhomave për kategori, numrin e tyre, hapësirat totale neto dhe bruto si dhe mesataren e hapësirës për nxënës (aneksi 1-05).

2.3.2 SHKOLLAT E MESME TË ULËTA DHE TË MESME TË LARTA - STANDARDE

Programimi i 12 standardeve të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta është bazuar në katër tabelat e punu-

ara në Excel të lidhura me njëra-tjetrën, duke filluar nga fondi zyrtar javor i orëve mësimore deri tek “planet e akomodimit”. Këto tabela janë:

- Fondi javor i orëve për shkollat publike sipas niveleve, lëndëve dhe klasave (Vëllimi 1, shtojca 06). Për nivelin e mesëm të lartë, tabela është e ndarë në katër ngarkesa të ndryshme të punës, një për secilin drejtim.
- Kurrikulumi dhe oraret kohore, që mundësojnë llogaritjen e numrit të përgjithshëm të orëve javore sipas lëndës për secilin nivel dhe madhësi të shkollës;
- Tabela e planit të akomodimit, që bën shpërndarjen e orëve të mësimdhënies sipas llojit të sallës dhe numrit të kërkuar të sallave me normën e tyre të shfrytëzimit dhe
- Plani i akomodimit të shkollës dhe tabelat e zonave që për çdo standard japin listën e sallave sipas kategorive, numrit, sipërfaqeve të përgjithshme neto dhe bruto dhe sipërfaqeve mesatare sipas nxënësve (Vëllimi 1, shtojcat 07 deri 08).

2.3.3 SHKOLLAT E ARSIMIT BAZIK (THEMELOR) - STANDARDET E NIVELIT PARAFILLOR, FILLOR DHE MESËM I ULËT

Programimi i 4 standardeve për shkollat bazike edukative është bazuar në planet e akomodimit të shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta. Ky programim është përgatitur në një fletë Excel, (Vëllimi 1 shtojca 7) me shpërndarjen si në vijim: (i) mësimdhënia dhe mbështetja pedagogjike e ndarë për secilin nga tre nivelet e edukimit dhe (ii) hapësirat e përbashkëta që mund të shfrytëzohen nga të tre nivelet janë: hapësirat e administratës, kantina, biblioteka, halla e sportive si dhe hapësirat tjera përcjellese teknike (shih paragrafin 1.5.2 më lartë).


2.4 FUNKSIONALITETI DHE FLEKSIBILITETI

2.4.1 FUNKSIONALITETI

Gjatë projektimit të ndërtësës shkollore, duhet të krijohet një bilanc mes cilësisë së funksionimit dhe efikasitetit të kostos. Ky bilanc mund të arrihet me mjete të ndryshme, siç janë:

- Dimensionet** racionale të hapësirave:
- Zonat e përshtatura të qarkullimit:** hapësirat e qarkullimit nuk duhet të kalojnë 25% të sipërfaqes së dobishme të ndërtuar. Ato duhet të kenë dimensione dhe të përshtaten sipas shfrytëzuesve të shkollës, ato duhet të jenë funksionale dhe të respektojnë kërkesat për siguri;
- Numri optimal i hapësirave:** numri i hapësirave fillimisht përcaktohet sipas shfrytëzimit (shihni paragrafin 2.2 më lartë, në planet e akomodimit). Në shkollat e vogla ku norma e pranueshme nuk mund të arrihet, në veçanti për hapësirat për mësimdhënie të specializuar, hapësirat për qëllime të shumëfishta duhet të merren parasysh;
- Përshtatshmëri maksimale:** hapësirat duhet të projektohen me një përshtatshmëri maksimale, që i mundëson ato të përshtaten për lëndë dhe ndryshime të ndryshme, në ato raste kur kjo përshtatet me kërkesat e tyre funksionale;
- Grupimi i hapësirave:** hapësirat duhet të grupohen në blloqe sipas funksionit dhe ndërlidhjes. Kjo do të siguronte një identifikim të lehtë të veprimtarive dhe hapësirave të tyre korresponduese, një komunikim të lehtë mes hapësirave të ndryshme, pa pengesa nëpër zonat e qarkullimit dhe ato të pritjes, një vëzhgim të lehtë të hapësirave dhe një shfrytëzim optimal të tokës në dispozicion;
- Integrimi i nevojave:** lokacioni i hapësirave brenda

Shembull I diagramit funksional të shkollës së mesme të lartë (01)



Lokacioni i shkollës

FIG. 1.2.6

shkollës duhet të ndjekë domosdoshmëritë themelore siç janë rregullat e sanitarisë dhe higjienës, rregulloret e komoditetit funksional dhe të sigurisë, si dhe komoditetin akustik, vizual e atë klimatik.

2.4.2 FLEKSIBILITETI

Dizajneri/projektuesi do të duhet të parasheh hapësirë të mjaftueshme për fleksibilitet për t'i mundësuar (i) personelit të shkollës që të përshtatet me ambientin e shkollës dhe me metodat e ndryshme të mësimdhënies; dhe (ii) për t'i mundësuar planifikuesve që të adaptohen me




FIG. 1-2.7

a) Fleksibiliteti i kërkuar për ndërtesa (dhe orënditë) që mundëson metoda të shumta të mësimdhënies (shih fig 1-2.8 më poshtë) për klasat e zakonshme (mësimi frontal, puna në grupe të vogla, mësimi në formë të

b) llojet e ndarjes së hapësirës që janë dhënë në programin e dizajnit/projektit duhet të projektohen

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	34



FIG.1-2.8

në struktura të cilat mund të modifikohen lehtë për t'iu përshtatur kërkesave në të ardhmen. Planifikimi me fleksibilitet është një konsiderim esencial në dizajnin/projektin e shkollave që të akomodojë evoluimin e vazhdueshëm në mendimin arsimor si dhe teknikat dhe teknologjitë e ndërtimit. I njëjti do të ndihmojë adaptimit të shkollës me shfrytëzimet e reja përmes ndryshimeve në planifikim dhe lejon këto ndryshime pa ndonjë kosto të madhe. Për këtë arsye, një plan fleksibil duhet gjithashtu të mundësojë adaptimet e lehta për zhvillimet në të ardhmen në planifikimin e hapësirës, ndërtimin e ndërtesave, ndriçimin artificial, teknikat e ventilimit dhe të akustikës. Bërja e një ndërtese shumë fleksibile (për shembull me numër të madh të mureve lëvizëse) përgjithësisht është shumë e shtrenjtë dhe mund të justifikohet vetëm në rast se ndryshimet janë të nevojshme dhe esenciale. Nuk ka shumë arsye që të vendosim për ndarje të shumta nëse ndryshimet bëhen vetëm një herë në vit. Në anën tjetër është e pëlqyeshme që të mënjanojnë sistemet strukturale, siç janë muret masive në mes të dhomave mësimore, që e bëjnë të vështirë dhe të kushtueshme largimin e mureve dhe ndryshimin e madhësisë së klasave më vonë. Kryesisht konstruksionet skeletore nga betoni ose metali (ose druri) do t'iu adaptoheshin më lehtë ndërrimeve të mundshme në të ardhmen.

2.5 DIZAJNI DHE ESTETIKA

Rëndësia e dukjes fizike të një shkolle publike nuk duhet të minimizohet. Një shkollë që është tërheqëse, që i përgjigjet dhe që është në përputhje me dizajnin dhe kontekstin e rrethinës, ngjallë një ndjenjë të krenarisë dhe pronësisë në mesin e nxënësve, mësimeve dhe të komunitetit. Gjithashtu, siç ndodhë me shumicën e ndërtesave kulturore, shkolla është simbol i njohurisë dhe përparimit të komunitetit.

Andaj, cilësia arkitekturale e ndërtesave të saj duhet t'i kontribuojë jo vetëm funksionalitetit të shkollës, por edhe integritet të saj në komunitet dhe ndërtimit të saj si simbol përmes:


- Rrënjësjes së një ndjenje të arkitekturës së mirë tek nxënësit përmes harmonisë dhe proporcioneve të hapësirave të ndërtuara, hapësirave të hapura, pamjeve (fasadave);
- Krijimit të një mjedisi të këndshëm në shkollë dhe mundësimin të shfrytëzuesve për të pëlqyer atë përmes përdorimit të materialeve, ngjyrave dhe bimëve, cilësisë së zonave të pritjes dhe të qarkullimit etj.
- Mundësimin të një identifikimi të lehtë të hapësirave të ndryshme përmes grupimit të tyre sipas aktiviteteve të tyre dhe përmes ofrimit të lidhjeve të lehta mes ndërtesave dhe hapësirave;
- Integritet të vlerave kulturore dhe elementeve specifike të mjedisit të komunitetit ku në këtë mënyrë do të ngritet ndjenja e përshtatshmërisë dhe krenarisë me shkollë;

Hapësirat e brendshme të shkollës duhet të pasqyrojnë dhe të theksojnë aktivitetet mësimore përmes:

- Ofrimit të një mjedisi të brendshëm i cili është vizualisht komod dhe gjallërues;
- Sigurimit të dritës së mjaftueshme natyrore dhe përdorimit të ngjyrave që kanë efekt gjallërues apo zbutës, varësisht nga funksioni i hapësirës;
- Sigurimi i shpërndarjes së dritës së diellit në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha klasat e mësimin dhe shmangies së dritës së fortë të diellit me rreze të drejtpërdrejta brenda klasave të mësimin.

Kualiteti i dizajnit duhet të diskutohet, vlerësohet dhe të kontrollohet në faza të ndryshme përgjatë procesit të hartimit dhe prokurimit. Kjo mund të mbështetet në gjërat që mund të maten në mënyrë shkencore, siç janë niveli i dritës në klasë, apo për aspekte të tjera më sub-

Vlerësimi i Kualitetit të Dizajnit/Projektit (VKD)



jektive siç janë atraktiviteti i objektit dhe si ndikon ai te përdoruesit e saj.

Në fillim të projektit ka shumë faktorë që duhet të konsiderohen dhe shumë pikëpamje individuale duhet të merren parasysh për vlerësimin e kualitetit prandaj, klienti (komunat dhe MASH/DI) mund të ndërmerr një Vlerësim të Kualitetit të Dizajnit (VKD).

Vlerësimi i Kualitetit të Dizajnit (VKD) është një mjet që konsiston në pyetësor me pyetje të parapërcaktuara që përbëhet nga tre tituj kryesorë: funksionaliteti, kualiteti i ndërtimit dhe shfrytëzimi. Ky mjet është zakonisht i hartuar që të përdoret në tre faza në një projekt për ndërtimin e shkollave (i) Përmbledhja e Dizajnerit/projektuesit (që ndihmon në përgatiten e përmbledhjes së arkitektit/

detyrës projektuese), (ii) Dizajni i mesëm (vlerësimi i propozimit kundrejt aspiratave origjinale); dhe (iii) Përdorimi (vlerësimi pas ndërtimit dhe përdorimit të se sa mirë ndërtesa plotëson kërkesat).

2.6 KOSTOJA DHE PARAMETRAT BUXHETOR

Materialet dhe teknikat e ndërtimit duhet të sigurojnë cilësinë arkitekturale, si dhe në të njëjtën kohë të përbushin kërkesat buxhetore. Prandaj projektuesi duhet të zgjedhë materialin dhe teknikat që krijojnë lidhjen më të

mirë të mundshme në mes të cilësisë, qëndrueshmërisë dhe koston.

Kapitali dhe buxhetet operative të shkollave zakonisht financohen nga burime të ndryshme, shpenzimet e tyre bëhen në kohë të ndryshme dhe ato menaxhohen nga shërbime dhe persona të ndryshëm. Si rezultat i kësaj, shpesh ka pak motivim për të faktorizuar koston afatgjatë të ndonjë ndërtese kur merren vendime në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e saj. Megjithatë, për të ulur koston e përgjithshme të një objekti dhe për të siguruar cilësinë e tij, është e nevojshme që projektimi fillestar dhe koston e ndërtimit të balancohen me shpenzimet rrjedhëse, siç është ndriçimi, ngrohja, ftohja, riparimi dhe operimi, si dhe mirëmbajtja e përgjithshme e objektit. Ky bilanc mund të arrihet nëpërmjet:

- Përdorimit të burimeve lokale (të materialeve dhe punës) dhe marrja parasysh e riciklueshmërisë së materialeve në kuadër të pragut të cilësisë;
- Lehtësimit dhe thjeshtësimit të projektimit dhe të ndërtimit;
- Qëndrueshmërisë për sa i përket efekteve të klimës dhe të shfrytëzimit intensiv nga nxënësit;
- Përzgjedhjes së elementeve të ndërtimit në bazë të analizës së koston së ciklit të jetës (krahasoni jetëgjatësinë e projekteve dhe sistemeve me jetëgjatësinë e pritur të ndërtesës);
- Materialeve dhe produkteve të specifikuar që janë të lehta për t'u mirëmbajtur;
- Sigurimi që ndërtesa do të veprojë në pajtim me qëllimin e dizajnit/projektit;
- Përdorimit të instrumenteve për simulimin dhe analizimin e energjisë për të optimizuar performancën e energjisë (integrimi i sistemeve të ndriçimit të ditës, ngrohjes, ajrosjes dhe kondicionimit të ajrit me performancë të lartë, izolimi i ndërtesës efikas për energji, si dhe ndriçimi elektrik me performancë të lartë); dhe
- Parashikimit dhe përgatitjes së një plani të lehtë dhe efikas të mirëmbajtjes me materiale të për-

shtatura dhe përmes përdorimit të aksesorëve dhe pjesëve rezervë që gjinden në lokalitet.

Pasi të jetë caktuar kosto kapitale e projektit dhe të jetë ndarë shuma e tij për elementet e ndryshme, është e rëndësishme që projektuesi menjëherë të bëjë një plan të detajuar të koston të bazuar në një sintezë të sipërfaqes bruto të përgjithshme të katit, duke përdorur numrin e përgjithshëm të kërkuar për çdo kategori të hapësirës me shtesat korresponduese të hapësirës. Për këtë, do të shtohet kompensimi për qarkullimin dhe strukturën me rreth 25% dhe pastaj kostoja për m² bruto mund të llogaritet nga shuma buxhetore e dhënë. Duhet të theksohet se kjo shtesë për strukturën dhe qarkullimin është e mjaftueshme dhe mund të konsiderohet se përmban kontingjencë. Shtesa e synuar, në projektin përfundimtar, duhet të jetë rreth 36%, e cila duhet të përfshijë 12 deri 14% për strukturën (dallimi në mes të sipërfaqes neto dhe të asaj bruto).

Shqyrtimi dhe kontrollimi i kostove të njëjësive në rezultatet e tenderëve të fundit do të tregojnë nëse hapësira totale e projektit mund të arrihet brenda buxhetit ose nëse ka shenja të ekonomisë së shkallës apo të ndonjë rritje të buxhetit. Një kontroll i tillë është thelbësor si pikë fillimi për punën e projektimit. Nëse ka mospërputhje negative të një shkalle të gjerë, atëherë, urgjentisht duhet të iniciohen diskutime me Departamentin teknik të ngarkuar me projektin. Një raport mbi rezultatin e kontrollimit të buxhetit duhet të përgatitet për çdo rast në raportin e parë të progresit.



3



3. PARIMET E PËRGJITHSHME

3.1 NORMAT TEKNIKE

Normat teknike për ndërtimtari, teknikat dhe materialet e ndërtimit ende nuk janë vendosur në Kosovë dhe profesionistët e sektorit të ndërtimtarisë janë duke u mbështetur në normat e jashtme, kryesisht në ato të BE-së, të vendeve të OBZHE-së dhe/apo të Shteteve të Bashkuara.

Normat teknike i referohen Ligjit të Ndërtimit Nr 04/4-110.

Përveç kësaj, Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) ka përgatitur standarde teknike të pranuar ndërkombëtarisht që mund të konsultohen dhe/ose të blihen nga anëtarët e saj. Këto norma që kanë të bëjnë me sektorë të ndryshëm janë të përfunduara në mënyrë të përhershme si dhe të azhurnuara. Standardet kryesore teknike që mund të zbatohen për ndërtimin e shkollave me lehtësi mund të konsultohen në internet nën referimet e mëposhtme:

■ STANDARDET ISO

Ref. ICS	Pjesët kryesore
91.06	Elementet e ndërtesave
91.08	Strukturat e ndërtesave
91.09	Strukturat e jashtme
91.10	Materiali ndërtimor
91.12	Mbrojtja e ndërtesave dhe mbrojtja brenda tyre
91.14	Instalimet nëpër ndërtesa
91.16	Ndriçimi
91.18	Punimet e brendshme
91.19	Pjesët shtesë të ndërtesave
93.00	Inxhinieria ndërtimore

TABELA 3.1

3.2 PARAMETRAT E KOMODITETIT

Ekzistojnë tri burime kryesore të mungesës së komoditetit fizik që trupi mund të përjetojë: temperatura, ndriçimi dhe zëri. Një sasi e cilësdo prej këtyre jashtë gamës së pranueshme do të shkaktonte mungesë të komoditetit. Qëllimi i projektimit të ndërtesave është që mjedisi i ndërtesave të arrihet në atë mënyrë që mungesa potenciale e komoditetit të jetë në nivel të pranueshëm. Kjo është një shkencë e pasaktë meqë shumë nga reagimet ndaj mungesës së komoditetit janë subjektive dhe dallojnë nga një individ tek tjetri. Megjithatë, studimet kanë treguar për një marrëveshje të gjerë mbi atë se cilat konsiderohen të jenë nivele të përshtatshme për secilin nga burimet. Cilësia e mjedisit brenda shkollës është posaçërisht e rëndësishme për nxënësit që të mësojnë në mënyrë efektive.

3.2.1 KOMODITETI KLIMATIK (TEMPERATURA)

(a) Përkufizimet dhe terminologjia

Komoditeti termik zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (i) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit në mes të kalorive të akumuluar dhe të humbura në trup, dhe (ii) kontrollit të kushteve klimatike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat.

Projektuesit e ndërtesave shkollore duhet të marrin parasysh kushtet klimatike të zonës ku parashihet të bëhet ndërtimi. Në këto udhëzime janë dhënë deklaratat të përgjithshme në lidhje me kushtet klimatike në Kosovë, por të dhëna shtesë dhe më të detajuara duhet të grumbullohen për kushtet e sakta të zonave përkatëse,

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	42

siç janë: (i) minimumi dhe maksimumi i temperaturës mesatare mujore, (ii) higrometria lokale, dhe (iii) erërat mbizotëruese për çdo stinë klimatike dhe shpeshtësia e erërave forta dhe stuhive.

(b) Kushtet klimatike të Kosovës

Në Kosovë mbizotëron një klimë kontinentale, gjë që rezulton në vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë me ndikime mesdhetare dhe alpine (temperatura mesatare brenda vendit është nga +30°C (në verë) deri në -10°C (në dimër). Megjithatë, për shkak të lartësive jo të barabarta në pjesë të caktuara të vendit, ka ndryshime për sa i përket temperaturës dhe të reshurave të shiut.

Dhjetori dhe janari konsiderohen si muajt më të ftohtë, dhe korriku dhe gushti si muajt më të ngrohtë të vitit. Shkalla maksimale e reshjeve të shiut arrihet në mes të tetorit dhe dhjetorit. Midis nëntorit dhe marsit, në Kosovë mund të pritët dëbora, madje edhe në pjesët e rrafshëta të vendit. Të reshurat më të mëdha të dëborës mund të priten në rajonet malore të Kosovës.

Lugina mes Mitrovicës dhe Kaçanikut i takon zonave më të thata të vendit. Si kontrast, rrafshi i Dukagjinit mes Pejës dhe Prizrenit përshkruhet si zonë shumë pjellore me më shumë reshje mes nëntorit dhe marsit.

Bazuar në kushtet klimatike, Kosova mund të ndahet në tri zona klimatike (shih fig. 4 më poshtë):

- Zona klimatike e **Kosovës (Rrafshi i Kosovës)**, që përfshin Luginën e Ibrit, ndikohet nga masa ajrore kontinentale. Për këtë arsye, në këtë pjesë të vendit, dimrat janë më të ftohtë me temperatura mesatare prej mbi -10°C, por nganjëherë deri në -26°C. Verat janë shumë të nxehta, me temperatura mesatare prej 20°C, me ndonjëherë deri në 37°C. Kjo zonë karakterizohet me një klimë të thatë dhe reshje vjetore totale prej përafërsisht 600mm në vit.
- Zona klimatike e **Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit)**, që përfshinë pellgun e lumit Drini i Bardhë, ndikohet shumë nga masat ajrore të ngrohta, të cilat kalojnë detin Adriatik. Temperaturat mesatare gjatë dimrit

janë prej nga 0.5°C, ndërsa të verës në 22.8°C.

Reshjet mesatare vjetore të kësaj zone klimatike janë rreth 700mm në vit. Dimri karakterizohet me reshje të mëdha dëbore.

- Zona klimatike e **pjesëve të bjeshkëve dhe maleve** karakterizohet me një klimë tipike malore, që karakterizohet me reshje të mëdha të shiut (900 deri 1300mm në vit), dhe vera që janë shumë të shkurta dhe të ftohta, dhe dimra të ftohtë dhe me shumë borë.

Në fundi, mund të thuhet se territori i Kosovës karakterizohet me një klimë me diell, me temperatura të dhe kushte të lagështisë të ndryshueshme.

(c) Përmirësimi i komoditetit klimatik

Për të përmirësuar komoditetin termik të hapësirave shkollore, masat e mundshme për kontrollin e klimës janë klasifikuar në dy kategori:

- Masat **natyrore** ose pasive, që përfshijnë orientimin e ndërtesës, pozitën dhe dimensionet e hapjeve, cilësinë e materialeve, izolimin termik, mbjelljen në afërsi të ndërtesave etj.
- Masat **artificiale** ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja apo kondicionimi i ajrit.

Për kontrollimin e efekteve klimatike në hapësirat shkollore, projektuesit duhet të ndërmarrin disa masa të thjeshta në fillim të procesit të projektimit. Këto masa kanë të bëjnë me:

- Orientimin** e ndërtesave: rekomandohet që orientimi i hapësirave të mësimi të jetë drejt jugut dhe veriut meqë ky orientim ofron mbrojtje nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ky orientim i preferuar mund të devijojë për rreth minus ose plus 30° (për shkak të kërkesave të lokacionit, ose për shkak të orientimit të erërave mbizotëruese) pa pasur ndonjë ndikim të madh në komoditetin e dhomave mësimore (shih fig.1-3.4 më poshtë);
- Vendosja** e ndërtesave: largësia në mes të balleve

Pamje skematike e zonave klimatike të Kosovës




FIG. 1-3.1

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	44

të ndërtesave duhet të jetë në proporcion me lartësinë e ndërtesave për të lejuar qarkullimin e ajrit të pastër dhe dritën natyrore edhe në nivelet më të ulëta. Për të njëjtat arsye, një largësi minimale prej 4m duhet të mbahet në mes të balleve kryesore dhe murit rrethues;

- III. Formën dhe dizajnin** e ndërtesave, si për shembull, mundësia e rrjedhjes së tërthortë të ajrit për ripërtëritjen e ajrit të freskët me ajrosje natyrore gjatë stinës së nxehtë, ose zgjedhja e kulmit me katër nivele të pjerrtësisë në zonat me reshtje të mëdha të dëborës;
- IV. Sipërfaqet e mbjella:** mbjellja e bimëve mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubave bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- V. Elementet e duhura të ndërtesës:** kjo përfshin kullimin e duhur nga çatia dhe kullimin rreth ndërtesave, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.
- VI. Materialet e duhura të ndërtimit,** që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit.

(d) Kontrolli aktiv i klimës

- (i) **Temperaturat e ulëta:** niveli komod i temperaturave më të ulëta mund të konsiderohet ai mes 19°C, për vendet ku ushtrohen veprimtari të punës që nuk përfshijnë lëvizje, dhe 15°C, për zonat e qarkullimit. Përpjekjet për të siguruar nxehtësi për t'i arritur këto nivele të temperaturave në mjediset e brendshme zakonisht nuk duhet të jenë shumë të larta. Megjithatë, një

minimum shumë më i ulët mund të ndodh në secilin prej muajve të sezonit të ngrohjes, ku sistemi i ngrohjes duhet të ketë kapacitetet të reagimit ndaj këtyre temperaturave të ulëta.

**■ TEMPERATURAT MINIMALE
TË REKOMANDUARA**

Klasat e mësimi	19°C
Depot	16°C
Korridoret	15°C
Zonat e sanitarisë	16°C
Punëtoritë	16°C
Hapësirat për qëllime të shumëfishta	19°C
Zyrat e administratës	19°C
Dhoma e mjekut	22°C

TABELA 3.2

Shfrytëzimi i shkollave gjithashtu është faktor që ndikon mbi zgjedhjet për komoditetin termik: orari javor i punës nëpër shkolla është në përgjithësi nga e hëna deri të premten prej orës 08:00 deri në 17:00 (ose më shumë në rastin e ndërrimeve të dyfishta), me një nevojë më të ulët për komoditet termik gjatë fundjavave dhe pushimeve dimërore prej dy javëve në dhjetor-janar, ku përdorimi i ngrohjes është minimal apo nuk kërkohet fare.

- (ii) **Temperaturat e larta:** Klima e Kosovës është kryesisht kontinentale e thatë dhe e nxehtë nga maji deri në shtator, ku shumica e ditëve gjatë kësaj periudhe janë me diell (shih par. 3.2.1 (b) më lart mbi klimën). Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti me variacione rajonale për shkak të lartësisë. Megjithatë, temperaturat e ajrit 28°C do të jetë kufiri për punë komode në shkollë, ku me lëvizjen e duhur të ajrit nga rrjedha e ajrit natyror nga dritaret e hapura dhe qarkullueset e ajrit, këto nivele zakonisht mund të arrihen në klasat e përgjithshme të mësimi gjatë vitit mësimor, me kusht që masat e kontrollit të përshkruara në paragrafin 3.2.1 të

zbatohen në projektimin e ndërtesave.

Megjithatë, nëpër sallat e specializuara siç janë laboratorët kompjuterikë ku punojnë monitorë me numër të nevojshëm për tërë klasën, temperatura mund të tejkalojnë 38°C dhe ftohja është e nevojshme. Laboratorët e tjerë gjithashtu mund të kenë nevojë për ftohje për shkak të aktiviteteve që gjenerojnë nxehtësi apo nevojës për të kufizuar shkallën e ajrosjes për përvoja të caktuara dhe punë praktike. Ftohja arrihet më së miri me anë të njësive të sistemeve të ndara ose kondicioner të ajrit, dhe do të ishte praktikë e mirë e projektimit që këto të sigurohen nëpër laboratorë. Njësi të kondicionimit të ajrit gjithashtu mund të përdoren edhe për hapësirat administrative të caktuara.

Ndërtimi tradicional i shkollave në Kosovë në përgjithësi ka izolim të mirë termik, që përbënë depërtimin e ngadaltë të nxehtësisë nëpër muret e jashtme ku kalimi i nxehtësisë në brendësi vonohet deri në kohën e pasdites, kohë kjo kur përfundon shfrytëzimi normal i shkollës. Një shkallë e përgjithshme e temperaturës së lartë gjatë ditës do të thoshte se me një menaxhim të mirë, shkolla mund të ajroset gjatë natës ku temperatura është e ulët, në mënyrë që ajo të jetë e freskët për fillimin e ditës së shkollës. Kjo do të ketë efekt mbi projektimin e dritareve dhe qarkulluesve të ajrit të brendshëm.

Shfrytëzimi i shkollës gjithashtu do të jetë një faktor i rëndësishëm për stinën më të ngrohtë, meqë viti shkollor përfshinë një pushim në korrik dhe gusht, muaj këta që konsiderohen si më të nxehtit dhe gjatë të cilëve nuk ka nevojë për kontroll të klimës artificiale.

(e) Kontrolli pasiv i klimës

Kontrolli mbi depërtimin dhe krijimin e nxehtësisë mund të minimizohet në mënyrë të natyrshme me një dizajn adekuat të mureve dhe suvatimit të ndërtesës. Burimi i nxehtësisë është dielli, andaj përjashtimi i dritës të drejtpërdrejtë të diellit nga ana e brendshme e ndërtesës është esenciale. Siç është cekur, muret e ngurta të jashtme mund të anashkalohen si burim i rëndësishëm i krijimit të nxehtësisë së brendshme gjatë ditës në shkollë. Kjo do të thotë se

dritaret janë elemente që kërkojnë vëmendje. Kjo arrihet në dy mënyra, **me orientim dhe reflektim të diellit**. Duhet të theksohet se mjetet për krijimin e hijeve nga dielli brenda qelqit nuk janë të efektshme meqë materiali ngrohet dhe krijohen reflektime në brendësi. Është thelbësore që të ndalohet goditja e diellit në qelq, nxehtësia nuk reflektohet jashtë përmes qelqit meqë gjatësia valore ndryshohet dhe serrat ngrohen. Duhet të theksohet se përdorimi i lustrimit të dyfishtë është i paefektshëm për ndalimin e depërtimit të diellit, kjo është efektive në parandalimin e humbjes së jashtme të nxehtësisë.

- (i). **Orientimi për diell:** drejtimi, ose orientimi, më i mirë për të pasur dritë esenciale të ditës në dritare është veriu-jugu (shiko fig. 3.3 më poshtë): Orientimi nga Veriu në Kosovë nuk reflekton drejtpërdrejtë dritë të diellit në krahun e dritares ndërsa orientimi nga Jugu reflekton rreze minimale, në dritare nën këndin më të vogël dhe të ngushtë gjatë ditës: në pjesën më të nxehtë të ditës, dielli do të jenë në zenit dhe këndi i rrezatimit të dritareve drejt jugut do të jetë më i ngushtë. Dielli nga ky orientim mund të reflektohet më së lehti.




FIG.1-3.3




FIG. 1-3.4

(iii). **Ndër-ajrosja (ventilimi i tërthortë)** do të jetë një faktor natyror i komfortit për pjesën më të nxehtë të vitit (shiko fig. 3.4 më poshtë) por në pikat më të larta mund të ketë më shumë nevojë për të nxjerrë jashtë ajrin që është ngrohur duke kaluar nëpër tokë të ngrohtë e të thatë. Sidoqoftë, ndërtesat me hapësira me opsion të hapjes në të dy anët, nuk janë ekonomike, ndonëse kjo mënyrë rekomandohet si më optimale. Shkolla, si çdo grup ndërtimi tjetër, do të ketë një pjerrtësi të shtypjes në kushte dhe drejtime të ndryshme të erës, në mënyrë që ajri të qarkullojë nëpër ndërtesë nga shtypja pozitive dhe negative, deri në atë masë që mundësohet nga ndarjet dhe hapësirat e brendshme. Në këtë mënyrë bëhet freskimi i mundshëm gjatë natës, e që të ndihmohet nga dritat e jashtme që futen nga dritaret e jashtme të nivelit të sipërm.

(iii). **Reflektimi i diellit:** pajisje efektive për reflektimin e diellit mund të projektohen për të funksionuar në çdo orientim, meqë këndi i diellit është plotësisht i parashikueshëm. Megjithatë, për shkak të ndryshimit sezonal në lartësi, përjashtimi i rrezeve të diellit gjatë vitit do të kërkojë elemente të lëvizshme. Në praktikë, reflektimi është zakonisht një kompromis, edhe pse në qoftë se orientim optimal është projektuar, reflektimi pas shqyrtimit do të jetë efektiv. Duke supozuar orientimin kah jugu, dritarja do të

reflektohet nga një raft i jashtëm horizontal në nivel të majës së dritares, me projektim që varet nga kohëzgjatja e vitit që dëshirohet për t'i parandaluar rrezet e diellit që të hynë në sallë apo që të bien në dritare. Gjatë dimrit, do të ketë përfitime nga rënia e diellit, kështu që këndi i rënies së diellit që duhet të përjashtohet është ai prej majit deri në tetor. Është e rëndësishë thelbësore që të ndalohej rënia e diellit në dritare pasi që nxehtësia është shumë e efektshme kur gjendet brenda dhe vet xhami nxehet, duke e rritur kështu efektin e ngrohjes. Duhet të theksohet se përdorimi i xhamave të dyfishtë është i paefektshëm në ndalimin e diellit, dhe është vetëm efektiv në parandalimin e humbjeve të diellit nga jashtë. Ndërtimi i një kulmi të madh të dalë jashtë apo masa e dritareve me grila janë pjesë e zgjidhjeve të zakonshme të mbrojtjes ndaj diellit (shih fig. 1-3.5 më poshtë)

Një alternativë e dritares me grilë është futja e raftit në strukturë të dritares në nivel të tërthores, gjegjësisht, rreth 2.00 m më lartë nga niveli i dyshemesë, me projektim të jashtëm dhe të brendshëm nga sipërfaqja e dritares. Kjo funksionon përmes reflektimit të projektimit të brendshëm nga dyshemeja dhe dielli që hyn nga pjesa mbi tërthoren dhe nga reflektimi i projektimit të jashtëm nga niveli më i ulët i rrezatimit të diellit.

Pjesa e epërme e raftit është reflektor i fortë, i cili refle-




FIG. 1-3.5

kton dritën në tavan, dhe kështu edhe në pjesën e prapme të sallës, duke e optimizuar kështu shpërndarjen e dritës së ditës. Ky aparat është më pak i efektshëm në eliminimin e nxehtësisë, pasi që mundësohet bartja e saj përmes pjesës së epërme të dritares.

Kjo mund të jetë përparësi në klasat shumë të gjata prej 8.00 m e më shumë, por në modelin e standardit të Kosovës prej 6.80 m, hyrja e dritës së diellit gjatë ditës është parë të jetë më shumë se adekuate.

3.2.2 KOMODITETI VIZUAL

(a) Përkufizimet dhe terminologjia

Nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat shkollore bazohet në: (i) **ndriçimin natyror që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e tërthortë e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme (shih tabelën 3.3 dhe 3.4 më poshtë);** (ii) **ndriçimin artificial** nga burimet e rrymës elektrike (poçet, tubat fluoreshent); (iii) **shkëlqimin** apo intensitetin e dritës qoftë nga burimi natyror apo ai artificial apo nga ndonjë sipërfaqe a objekt i padepërtueshëm që nuk është transparent; dhe (iv) **kontrastin** e shkëlqimit apo ngjyrës.

■ FAKTORËT MESATAR PËR REFLEKTIMIN E DITËS

Materiallet	%
Allçi	85
Letra e bardhë	84
Lyerja e bardhë	75
Çimentoja	55
Gurë grihe	50
Lënda natyrore e drurit (ngjyrë e lehtë)	33
Tullat e kuqe	20

TABELA 3.3

(b) Të gjeturat nga studimet paraprake

Shkëlqimi i tepërt mund të shkaktojë mungesë të thekshme të komoditetit dhe në rastin e klasës së mësimi mund të shkaktojë kokëdhimbje dhe të parandalojë mësimdhënien dhe mësimnxënien efektive. Sasia e dritës së diellit mbi sipërfaqet e pahijezuara të punës në Kosovë është mbi 1000 luks dhe niveli komod për punë duhet të jetë 300 deri 400 luks (shih tabelën 3.4 më poshtë). Studimet tregojnë për një dritë të diellit adekuate në fund të klasës së zakonshme të mësimi dhe shtimi i reflektimit të diellit, siç është diskutuar më lartë, do të ulë intensitetin afër dritareve. Roletet e brendshme të dritareve mund të jenë mënyra e vetme e

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	48

uljes së dritës në një ditë me shumë diell dhe do të jetë e duhur që projektuesit të bëjnë zgjidhje për drejtimin e nevojshëm.

■ VLERA KRAHASUESE E NDRIÇIMIT NË LUKS

Lokacioni	Ndriçimi (luks)
Jashtë, mot me plot diell në mesditë	80,000 deri 100,000
Brenda, afër dritares me qiell të kthjellët:	
- 0,50 m nga dritarja	2,000 deri 4,000
- 1,50 m nga dritarja	700 deri 900
Vendi i punës /poç 60W 0,60 m lartësi	500 deri 700

TABELA 3.4

(c) Masat e rekomanduara

Projektuesit duhet të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar komoditetin e ndriçimit që është esencial për një performancë të mirë dhe komoditet vizual të nxënësve dhe personelit të shkollës. Ato janë:

(i) Ndriçimi natyror:

- Për të kufizuar përdorimin e ndriçimit të shtrenjtë artificial, plani(projekti) i ndërtësës dhe i dhomave mësimore duhet të maksimizojë përdorimin e dritës natyrore dhe në këtë mënyrë do të minimizohet rrezatimi i mundshëm që mund të ndodhë gjatë periudhave të caktuara të ditës;
- Niveli i mirë i ndriçimit është i rëndësishëm në zonat e qarkullimit për të minimizuar rrezikun nga aksidentet;
- Distancat mes balleve duhet të lejojnë depërtimin e mjaftueshëm të dritës nëpër ndërtesa. Këto rekomandime mbi këtë lloj distance zbatohen edhe për komoditetin klimatik;
- Numri, dimensionimi, vendosja dhe aranzhimet e dritareve duhet të jenë në përputhje me sasinë e kërkuar të dritës (dhe rrjedhën e ajrit). Duke pas parasysh rëndësinë e ndriçimit natyror, rekomandohet që e tërë sipërfaqja e dritareve në hapësirat e mësi-

- mit të jetë 15 deri 20% e sipërfaqes së dyshemesë;
- Thellësia e sallave mund të ndikojë në ndriçimin natyror për hapësirat në anën e kundërt të dritareve. Andaj rekomandohet që të shmangen thellësitë e hapësirave që tejkalojnë 7.00 m;
- Kur kemi streha, amortizatorë dritarësh apo grila për mbrojtjen e dritareve, efekti i tyre në dritën e ditës duhet të studiohet me kujdes;
- Mbjellja e drunjve dhe shkurreve mund të kufizojë intensitetin e dritës, varësisht nga përmasat dhe format, si dhe llojet e gjetheve dhe distanca nga ndërtesat.

(ii) Ndriçimi artificial:

- Disa aktivitete shkollore në mënyrë të domosdoshme kërkojnë ndriçim të duhur artificial, në veçanti gjatë kohës së dimrit dhe në fund të ditës apo gjatë ditëve me re.
- Instalimi i pajisjeve të ndriçimit gjithashtu mund të mundësojë zgjatjen e orëve të punës (ndërrimet e dyfishta, mësimet në orët e vona, takimet...);
- Lloji i pajisjeve të ndriçimit që duhet të instalohen varet nga intensiteti i dritës që kërkohet dhe nga lloji i aktivitetit përkatës. Megjithatë tubat fluoreshente, krahasuar me poçet inkandeshente, kanë përparësinë e reflektimit të ulët të sipërfaqeve, efikasitet të lartë, shpërndarje të mirë të dritës, prodhim të ulët të nxehtësisë;
- Në Kosovë nuk ka standarde precize për sa i përket sasisë së dritës që kërkohet nëpër ndërtesat shkollore, por rekomandohet të përdoren standardet mesatare si në vijim:

Sallat	Përgjithësi	Plani i punës*
Depot, arkivat	200	nuk ka
Dhomat mësimore	300 deri 500	375
Laboratorët, bibliotekat	500 deri 600	450
Zyrat, administrata	400 deri 500	375
Korridoret dhe shkallët	200	nuk ka
Korridoret dhe sallat e pritjeve	250	nuk ka
Hapësira për shumë qëllime	350	nuk ka
Ndriçimi i dërrasës së shkrimit (* Në 75cm mbi planin e punës)	nuk ka	400

TABELA 1-3.5

- Ndërprerës të posaçëm duhet të sigurohen për kontrollin e ndriçimit në të gjitha hapësirat. Për sipërfaqet që tejkalojnë 20 m², duhet të instalohen ndërprerës për errësimin e dritës apo të shumëfishtë për të ulur intensitetin e dritës.
- Projektimi i ndërtesës dhe lloji i pajisjeve të ndriçimit duhet kenë qasjen e mirëmbajtjes së lehtë, në veçanti në vendet e larta të tavanit.

(iii) Këndet vizuale dhe largësitë

Shpesh nxënësit ankohen se nuk janë në gjendje t'i shohin qartë mjetet vizuale të konkretizimit siç janë dërrasat e bardha dhe video-ekranet. Shpesh shkëlqimi është shkaktar i pamundësisë së nxënësit për të parë qartë. Një faktor tjetër i rëndësishëm është këndi i vijës së shikimit përgjatë të cilës ata shikojnë. Pamundësia për të parë qartë mund ta shtyjë nxënësin që të marrë një pozitë të parehatshme dhe kjo mungesë komoditeti mund të ketë për pasojë humbjen e përqendrimit. Kjo është posaçërisht e vërtetë për nxënësit e moshave më të reja, këndi i shikimit i të cilëve e shtrembëron imazhin madje edhe nëse nuk ka shkëlqim të fortë.

Ekzistojnë disa dëshmi se nxënësit të cilët janë të vendosur aty ku këndi i shikimit është ekstrem, ose largësia

nga mjeti i konkretizimit është tepër e madhe, ata kanë të ngjarë të kenë rezultate të dobëta në mësim. Nëse thuhet se të gjithë nxënësit duhet të kenë mundësi të barabarta arsimimi, pavarësisht se ku ulen, atëherë projektuesi duhet t'i kushtojë rëndësi më të madhe aranzhimit të ulëseve, ashtu që:

- Largësia maksimale ndërmjet rreshtit të fundit të nxënësve dhe dërrasës së shkrimit të jetë rreth 9.0 m. Përtej kësaj largësie është e vështirë të lexohen ato që janë shkruar dhe nxënësit sforcohen shumë për t'u koncentruar, për të qenë në gjendje ta kuptojnë tekstin e shkruar;
- Largësia minimale ndërmjet rreshtit të parë dhe dërrasës së shkrimit të jetë rreth 2.0 m. Nën këtë largësi, nxënësit e rreshtit të parë nuk do të jenë në gjendje ta shohin tërë dërrasën e shkrimit nga një kënd i pranueshëm vizual (shih fig. më poshtë);
- Këndi vizual minimal deri te dërrasa e shkrimit duhet të jetë 30° (shih fig. 1.3.6 më poshtë) ashtu që këndi në të cilin shikohet mjeti mësimor i konkretizimit nuk e shtrembëron të kuptuarit nga nxënësit të asaj që ata shohin (nën 30°, leximi i atyre që janë shkruar vështirësohet);
- Drita kryesore natyrale duhet të jetë, sa më shumë që është e mundur, e vendosur në anën e majtë të nxënësve, ashtu që hija e dorës së tyre të mos bartet në tekstin ose vizatimin që janë duke e bërë.


3.2.3 KOMODITETI AKUSTIK

(a) Përkufizimet dhe terminologjia


Para se të rekomandohen masa për të përmirësuar komoditetin akustik nëpër ndërtesat shkollore, duhet të bëhet përkufizimi i termeve dhe nocioneve që kanë të bëjnë me akustikën:

- Zëri është valë e shtypjes në një medium elastik. Nëse nuk kufizohet, ai përhapet nga burimi në të gjitha drejtimet dhe intensiteti bie me shtimin e distancës**

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	50



KOMODITETI PËR DHOMË MËSIMI
ME 3 RENDE BANKASH
(30-36 dhe 42 nxënës në raste të jashtëzakonshme)



KOMODITETI PËR DHOMË MËSIMI
ME 3 RENDE BANKASH
(32 dhe 40 nxënës në raste të jashtëzakonshme)

FIG. 1-3.6

nga burimi. Zëri lëvizë rreth 0.344 m/sekondë në ajër dhe me një shpejtësi më të lartë në materialet me densitet më të lartë siç është druri, çeliku, betoni, etj.

- (ii) **Transmetimi** i zërit përmes ndonjë materiali varet nga dendësia dhe njëtrajtësia e tij. Në materialet e njëtrajtshme, siç është çeliku, zëri transmetohet me një efikasitet më të lartë sesa në mjetet e tjera jo të njëtrajtshme siç është muri prej tullave;
- (iii) **Intensiteti** i zërit është niveli i transmetimit të energjisë së zërit. Ky intensitet matet me decibelë (dB);
- (iv) Frekuenca e zërit është matja e numrit të valëve të shtypjes në sekondë që prodhohen nga ky zë. Veshi mesatar i njeriut reagon ndaj 16 deri 16,000 valëve të frekuencave në sekondë;
- (v) **Absorbimi** paraqet pjesën e zërit që mbetet në materiale dhe asnjëherë nuk del nga aty. Sa më poroz të jetë materiali aq më i lartë është absorbimi dhe sipërfaqet strukturale, njerëzit apo orenditë gjithash të absorbojnë një pjesë të zërave.

(b) Të gjeturat nga studimet paraprake

Mungesa e komoditetit akustik mund të vije nga burimet e jashtme apo ato të brendshme. Mjedisi akustik në shkolla mund të jetë shumë i zëshëm, në veçanti gjatë kohës kur nxënësit hynë, dalin apo janë në pushime nga mësimi. Kur nxënësit janë në dhomë mësimore, ekziston nevoja për një nivel të kontrolluar të zërit në mënyrë që ajo që është për t'u dëgjuar të dëgjohet me qartësi. Fatkeqësisht, punimet tradicionale të shtresave të fundit dhe sipërfaqet në shumë prej shkollave të Kosovës janë të ngurta dhe reflektuese, ku krijohen jehona të zërit dhe koha e jehonës mund të jetë e gjatë, edhe pse në klasat e mësimi kjo jehonë nuk duhet të jetë e konsiderueshme. Kuptueshmëria e shpjegimit të mësimdhënësve në klasat e mësimi megjithatë varet edhe nga niveli i zhurmës në sfond. Ekzistojnë tri burime të zërave të padëshirueshëm nga sfondi që duhet të kontrollohen:

- (i) Nga hapësirat fqinje të mësimi;
- (ii) Nga burimet e zhurmave madhore brenda shkollës,

siç janë punëtoria, hapësirat e qëllimeve të shumfishta dhe korridoret, si dhe nga fushat e lojës dhe burimet e tjera të zhurmës nga hapësirat e jashtme të shkollës;

- (iii) Nga burimet e tjera jashtë lokacionit.

(c) Masat e rekomanduara

Për të siguruar një mjedis të mirë për dëgjim, pikat e paraqitura në vijim duhet të merren parasysh gjatë projektimit të shkollës:

- (i) **Lokacioni i shkollës:** zhurma e jashtme mund të kontrollohet duke vendosur ndërtesat e shkollës sa më lartë që është e mundur nga zonat ndarëse të zhurmshme, duke orientuar hapësirat e mësimi larg nga burimet e zhurmës, duke ndërtuar mure rrethuese rreth shkollës apo duke shtuar sipërfaqet e mbjella për të kufizuar depërtimin e zhurmës nga jashtë (nga tregjet, autostradat, stacionet ...).
- (ii) **Lokacioni i ndërtesave:** për sa i përket burimeve të brendshme dhe atyre të jashtme të zhurmës, p.sh. fushat e lojës, hapësirat për qëllime të shumfishta, hapësira e muzikës dhe hapësirat e tjera ku prodhohen nivele të larta të zërit duhet të vendosen sa më larg që të jetë e mundur nga ndërtesat që kanë dhomë mësimore, dhe hapësirat e tjera të qeta.
- (iii) **Plani i hapësirave:** nxënësit në dhomë mësimore apo në punëtori të diskutimeve në grupe duhet të vendosen në distanca praktike nga mësimdhënësit. Laboratorët më të mëdhenj dhe hapësirat e mësimdhënies duhet të kenë një madhësi ku distanca deri tek mësimdhënësi dhe dërrasa e shkrimit nuk është më shumë se 9 metra nga rreshti i fundit;
- (iv) **Izolimi i zërit:** duhet të ndërmerren masa për të siguruar një izolim të mjaftueshëm të zërit mes hapësirave (dhomave mësimore, sallave, zyrave...)

për të parandaluar pengesat e shkaktuara nga zhurmat e jashtme apo ato të brendshme. Materiali i ngurtë, siç është muri prej tullave mes ndonjë burimi të zhurmës dhe ndonjë aktiviteti mësimor në afërsi do të rezultojë në ulje të decibelëve.

- (v) **Materialët dhe teknikat** duhet të përshtaten për kontrollimin e zhurmës mes hapësirave të jashtme dhe atyre të brendshme: përdorimi i materialeve absorbuese në tavan, ndërtimi i mureve të dyfishta të jashtme të ndara me një zbrazëti të mbushur me materiale izoluese (polistiren), muret ndarëse dhe muret me trashësi 18cm mes klasave të mësimi, materiali i shtresës përfundimtare nëpër dysheme që ndihmon në uljen e zhurmës, mbushja e nyjave mes gypave dhe tubave të ajrit... etj.

3.3 PROJEKTIMI PËR NJË MJEDIS HIGJENIK

3.3.1 HAPËSIRAT E BRENDSHME TË SANITARISË

Cilësia e mjedisit higjienik në shkollë varet nga projektimi, përzgjedhja e pajisjeve për shfrytëzim nga nxënësit, personeli (mësimdhënësi, administrativë, shërbyes), si dhe nga mysafirët, por edhe nga mirëmbajtja dhe menaxhimi i shfrytëzimit të këtyre pajisjeve. Në tabelat e akomodimit standard (Vëllimi 1, shtojca 6 deri 7) është paraqitur numri i pajisjeve dhe ndërtesave të ilustruara në tabelën 3 (shërbimet e përbashkëta). Këto pajisje, nëse mirëmbahen mirë do të sigurojnë nivelin e tualeteve, banjave dhe furnizimit me ujë që kërkohet brenda ndërtesave shkollë. Përveç këtyre ekzistojnë edhe komponentët e jashtëm të këtyre shërbimeve, menaxhimi i mirë i të cilave është thelbësor për higjienën dhe funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve të brendshme.

SANITARIET TË KUÇURA NË RRJETIN PUBLIK TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT




FIG.1-3.7

3.3.2 TRAJTIMI I UJËRAVE TË ZEZA DHE ATMOSFERIKE

Në përgjithësi, ekzistojnë tri lloje të ujërave që duhet të trajtohen dhe të qiten jashtë ndërtesave shkollore. Këto janë: (i) të gjitha ujërat e tualeteve; (ii) **ujërat nga vaska, dushi dhe lavamanet**; dhe (iii) **ujërat nga shirat**, nga kulmet apo hapësirat e jashtme. Përveç kësaj mund të nevojiten edhe trajtime të posaçme për ujërat e yndyrshme (ujërat me përmbajtje të vajit dhe yndyrës) apo për ujërat acidike që përdoren në laborator (paratrajtim i posaçëm). Trajtimi

i ujërave dallon nga një vend në tjetrin, varësisht nga disponueshmëria e rrjetit të kanalizimit të qytetit, dhe mundësia e lidhjes me sistemin e ujësjellësit:

(a) Lokacionet e shkollave me rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit publik

Të gjitha ujërat mund të dërgohen drejtpërdrejtë në rrjetin e kanalizimit (shih ilustrimin 1-3.7 më poshtë). Rekomandohet që ujërat atmosferike nga kulmet të grumbullohen në një rezervuar të ndarë në mënyrë që ai ujë të shfrytëzohet për ujitjen e hapësirave të gjetbëruara në oborr të shkollës.

SANITARIET TË KYÇURA NË RRJETIN PUBLIK TË UJËSJELLËSIT POR JO DHE NË RRJETIN E KANALIZIMIT




FIG.1-3.8

(b). Lokacionet e shkollave që kanë furnizim me ujë por që nuk janë të lidhura me rrjetin e kanalizimit publik: Në këtë rast nuk ka alternativë tjetër pos të gjendet një zgjidhje përmes gropës septike për të gjitha mbeturinat e lëngshme nga objektet sanitare, laboratorët dhe kantinat e shkollës... Në çdo rast sistemi i përzgjedhur për trajtimin e mbeturinave duhet të jetë ekologjik dhe të mos shkaktojë bezdi për fqinjësinë. Dy zgjidhje kryesore me variacione të ndryshme u ofrohen projek-

tuesve për të zgjidhur problemin e trajtimit të ujit në vend. Ato janë:

- Sistemi tradicional (shih fig.1- 3.8 më poshtë) me dy ose tre gropat septike, nga të cilat ujërat e trajtuar dërgohen në filtër dhe depërtojnë në tokë përmes një mihje për thithjen e ujit apo shtratit të filtrimit. Ky sistem zakonisht projektohet me rrjete të ndara për ujërat nga tualetet (që kalojnë nëpër rezervuarin e gropës septike) dhe për ujërat e mbetura që shkarkohen drejtpërdrejtë në mihjen për thithjen

SANITARIET PA KYÇJE NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT




FIG. 1-3.9

e këtyre ujërave (fusha përgjegjëse për drenim të këtyre ujërave). Gropat septike mund të shoqërohen me njësi të tjera për trajtimin e ujërave të mbetura në vend, siç janë biofilterët apo sistemet aerobike që përfshijnë ajrosjen artificiale.

- ii. Sistemi i ri që përfshinë dy rezervuarë të mbyllur, ku i pari ka rolin ndarës dhe i dyti atë mbajtës, nga i cili mbetjet nga tualetet pompohen rregullisht në një rezervuar dhe dërgohen në rezervuarin qendror të trajtimit. Mbetjet e ngurta në rezervuarin e parë

gjithashtu duhet të hiqen herë pas herë.

- (d) **Shkollat që nuk kanë furnizim nga ujësjellësi (zonat e largëta rurale):** Zgjidhja e vetme në rast se nuk ka ujë nga ujësjellësi është ndërtimi i tualeteve të jashtme me rezervuarë të ujit (shih ilustrimin 1-3.9 më poshtë)

Të gjitha këto sisteme të pavarura për trajtimin e mbetjeve të lëngshme duhet të jenë: (i) të qasshme për

largimin e mbetjeve të ngurta; (ii) në largësi nga themelet e ndërtesave shkollorë së paku 3 m; (iii) në largësi nga pusët e ujit së paku 50 m dhe (iv) të ajrosen e mirëmbahen mirë.

3.3.3 GYPAT PËR UJËRAT E ZEZA

Gypat për ujërat e zeza duhet t'i respektojnë kushtet sanitare dhe ekologjike. Secili gyp duhet të ketë madhësinë që përputhet me sasinë e mbetjeve të lëngshme në kohën e shfrytëzimit maksimal. Ata gjithashtu duhet të jenë të mbyllur mirë, për të parandaluar depërtimin e insekteve të dëmshme dhe shtazëve të vogla, si dhe për të parandaluar rrjedhën e mbetjeve. Aspektet kryesore që duhet të merren parasysh gjatë instalimit të gypave të ujërave të zeza janë:

- Rënia e lirë e gypave duhet të jetë e vazhdueshme pa variacione, mes 2% dhe 2.5% për ujërat atmosferike dhe 3% deri në 3.5% për ujërat e zeza . Për këtë arsye projektuesi duhet që sa më shumë që të jetë e mundur të mundohet t'i vendosë gropat septike afër tualeteve;
- Diametri minimal i gypit të kanalizimit duhet të jetë 100 mm dhe diametri i minimal i gypave të ujërave atmosferike duhet të jetë 80 mm;
- Lidhjet e gypave duhet të jenë në formën Y, dhe këndet e drejtimit pa puseta duhet të jenë më të vogla se 30 shkallë;
- Pusetat duhet të ndërtohen në çdo ndryshim të drejtimit, këndi i së cilit është më i madh se 30 shkallë (vertikalisht ose horizontalisht);
- Largësitë mes pusetave duhet të respektojnë kushtet për të mundësuar një qasje të lehtë dhe mirëmbajtje (referohuni tek normat specifike të ndërtimit: rreth 30m minimum për gypat e kanalizimit dhe 30 m për gypat e tjerë) ;
- Secila pajisje sanitare duhet të ketë sifon për të eliminuar kundërmimet dhe për të filtruar mbetjet

e mëdha të ngurta që mund ta bllokojnë sistemin e gypave;

- Të gjitha shkarkimet e ujërave të zeza duhen të ajrosen me anë të gypit vertikal për ajrosje.

3.3.4 FURNIZIMI ME UJË DHE REZERVUARËT E UJIT

Cilësia e ujit duhet të testohet nga laborator i specializuar. Rezultatet e testit duhet t'i plotësojnë kriteret për ujë të pijshëm dhe, nëse testi paraqet karakteristika jo të duhura të ujit, duhet të identifikohet dhe të ofrohet sistemi për trajtimin e tyre.

(a) Furnizimi me ujë

Uji zakonisht vjen nga ujësjellësi publik apo nga mënyrat alternative, siç janë burimet (pusët), ujësjellësi me rënie të lirë apo në viset rurale përmes transportit me kamionë.

Furnizimi mesatar i ujit për shkolla në përgjithësi bazohet në konsumin e ujit për një nxënës gjatë ditës. Megjithatë, ky konsum mesatar që mund të rritet prej 20%-30% gjatë stinës së verës është si në vijim:

- 1.5 litra të ujit të pijshëm për nxënës dhe për punonjës;
- 6.0 litra për nxënës për pastrim dhe konsum në tualet;
- 10.0 litra për ulëse në ditë për laborator

(b) Transporti i ujit

Furnizimi i ujit deri në shkollë bëhet përmes gypave të galvanizuar të çelikut apo përmes atyre plastik siç janë: PE, PEHU, PPR . Nëse furnizimi dhe shtypja e ujit janë të parregullta (kryesisht në vendet rurale), atëherë furnizimi bëhet përmes rezervuarit të ujit. Të gjithë gypat e ujësjellësit në shkollë duhet të kenë hapje për kontrollim, rubineta dhe rubineta kryesore (për ndërprerje të ujit) për qëllime të mirëmbajtjes dhe izolimit. Gypat duhet të jenë të vendosur paralelisht me muret dhe pllakat me

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	56

numër minimal të kthesave, si dhe duhet të jenë të instaluar larg nga pajisjet elektrike, siç është transformatori, hapësira për ashensor, kabllot elektrike, etj.

(c) Ruajtja e ujit

Për ruajtjen e ujit kërkohet cisterna e prodhuar nga çeliku i galvanizuar apo nga material tjetër që është rezistues dhe që plotëson kushtet higjienike për depozitimin e ujit të pijshëm. Pozita apo vendndodhja e këtyre cisternave do të rregullohet në atë mënyrë që të ekzistojë rënia e lirë e duhur kurdo që kërkohet për furnizim me ujë të gjitha pjesëve të shkollës.

ujërave, në rezervuare të ujërave apo në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

(c) Drenazhimi i kulmit

Kulmi i ndërtesave duhet të planifikohet në atë mënyrë që të mundësojë drenazhimin e ujërave atmosferike:

(i) kulmet e rrafshëta nga pllakat e çimentos duhet të kenë pjerrtësinë minimale prej 1% që shkon drejt pikave dalëse dhe tek gypat vertikalë të drenazhimit; (ii) kulmet e pjerrëta të ndërtesave disakatëshe duhet të kenë uluqet dhe gypat vertikalë të drenazhimit, të lidhura me sistemin kryesor të drenazhimit në lokacion.

3.3.5 DRENAZHIMI I LOKACIONIT

Drenazhimi i lokacionit të shkollës përfshinë shkallëzimin e përgjithshëm të lokacionit, sistemin e drenazhimit të ujërave pas shtrëngatave dhe atë të ujërave atmosferike.

(a) Shkallëzimi i lokacionit

Nëse lokacioni nuk ka pjerrtësi natyrale, duhet të shkallëzohet në atë mënyrë që të gjitha sipërfaqet të jenë të pjerrëta në largësi prej ndërtesave sipas shkallës minimale prej 1%. Të gjitha hapësirat e hapura përreth ndërtesave, duke përfshirë sipërfaqet e shërbimit dhe ato të parkingut duhet të shkallëzohen ashtu që të mos rrjedh uji atmosferik në ndërtesa, nëse pusetat e ujërave atmosferike stërngarkohen.

(b) Sistemi i drenazhit të ujërave atmosferikë

I tërë drenazhimi i lokacionit nga ndërtimet e reja apo nga ndërtesat ekzistuese lidhen me sistemin ekzistues të drenazhimit të ujërave atmosferikë dhe të gjitha rrjedhat e ujërave atmosferikë nga hapësirat e shtruara (terrenet sportive, ato për lojëra, rrugët, vendparkimet, dhe shtigjet) mbledhen në kanalet për drenazhim të ujërave atmosferike apo në kanale të hapura dhe do të barten përmes gypave nëntokësorë në vendgrumbullim të

3.3.6 AJROSJA E MJEDISEVE

Ajrosja e mjediseve të shkollës përmirëson shumë higjienën brenda objektit, duke eliminuar lagështinë, lagështinë nga muret, nga ndarjet e hapësirave dhe nga hapjet, si dhe duke larguar insektet që bartin sëmundje. Përveç kësaj, lëvizjet e ajrit ndihmojnë në zvogëlimin e disa sëmundjeve, siç janë mukozat, duke zvogëluar temperaturën trupore, dhe rrjedhimisht duke zvogëluar djersitjen e nxënësve dhe të punonjësve përmes avullimit dhe rrymimit. Ajrosja e ndërtesave shkollore mund të bëhet përmes:

(a) Ajrosjes së natyrshme

Ajrosja e natyrshme, për dallim nga ajrosja e sforcuar me ventilator, shfrytëzon erën dhe rrymimet e saj për futjen e ajrit të pastër në ndërtesa. Ajri i pastër është i nevojshëm për ndërtesa për të eliminuar kundërmimet, për furnizim me oksigjen dhe për rritjen e komoditetit termal.

Era shkakton shtypje pozitive në pjesën e rrahur nga era dhe shtypje negative në pjesën që nuk rrihet nga era. Për të barazuar shtypjen, ajri i pastër do të hyjë në çfarëdo hapje që gjendet në anën e rrahur nga era dhe do të del nga çfarëdo hapje nga ana që nuk rrihet nga era.

Gjatë verës, era shfrytëzohet për futjen sa më të madhe të ajrit që të jetë e mundur, ndërsa gjatë dimrit, ajrosja zakonisht zvogëlohet në nivele të mjaftueshme për të hequr lagështinë e tepërt dhe ndotësit.

Për të pasur ajrosje të mirë të natyrshme, është me rëndësi (i) të mos ketë pengesa mes hapjeve në drejtim që rrahet nga era dhe hapjeve në drejtimin që nuk rrahet nga era; (ii) të mos ketë ndarje në dhomë që kanë orientim perpendikular me drejtimin e ajrit. Nga ana tjetër, plani i pranuar i objektit nuk duhet të ketë dritare ku hynë era dhe ato ku del të vendosura përballë njëra-tjetrës, me qëllim rritjes së përzierjes së ajrosjes dhe përmirësimit të efektshmërisë së saj.

Efektshmëria e ajrosjes së brendshme kur krahasohet me fuqinë e jashtme të erës varet nga këndi i erës dhe madhësia relative e hapjeve hyrëse dhe dalëse të erës. Kjo efektshmëri sillet prej rreth 80% të erës që hyn në objekt të orientuar në mënyrë perpendikulare ndaj erës mbizotëruese, e deri në 40% me hapjen në kënd prej 45 shkallësh.

(shih paragrafin 3.2.1 (e) për komoditetin klimatik)

(b) Ajrosja mekanike

Ajrosja mekanike mund të jetë e nevojshme: (i) në regjionet me numër domethënës të ditëve të nxehta dhe pa erë gjatë vitit shkollor; (ii) në ndërtesat ekzistuese ku ajrosja e duhur natyrore fizikisht është jopraktike për shkak të konfigurimit të ndërtesës; (iii) në dhomat e specializuara, siç janë dhomat e muzikës; dhomat që kanë numër të konsiderueshëm të pajisjeve që lirojnë nxehtësi, siç janë kompjuterët, hapësirat për shumë qëllime the sallat sportive dhe (IV) hapësirat me burime të ndotësve, të cilat duhet të nxjerrën në burim, siç janë pajisjet për gatimin e ushqimit, punëtoritë dhe laboratorët.

Ajrosja mekanike në fakt është metodë e futjes së ajrit të pastër në hapësirë përmes ventilatorëve dhe tubacioneve,; ventilatorët për nxjerrjen e ajrit, pajisjet e kondicionimit të ajrit, sistemet ndarëse, sistemet për ruajtjen e nxehtësisë apo pompat e nxehtësisë. Të gjitha këto sisteme të ajrosjes mekanike duhet të dizajnohen

nga inxhinieri me përvojë në fushën e ngrohjes dhe të ajrosjes për të siguruar: (i) shpërndarjen e drejtë të ajrit; (ii) temperaturën dhe lagështinë e duhur; (iii) filtrimin e kënaqshëm të ajrit; (iv) zhurmën e ulët dhe (v) funksionimin ekonomik.

Përparësitë kryesore të këtyre sistemeve janë kontrolli më i mirë i ajrosjes dhe i temperaturës së brendshme, si dhe më pak prani të pluhurit dhe ndyrësirës. Mirëpo, shpenzimet e funksionimit të këtyre sistemeve mund të jenë shumë të mëdha për buxhetin e shkollës.

3.4 ELEMENTET TEKNIKE SPECIFIKE

3.2.4 NGROHJA

Gjatë llogaritjes së ngarkesës së nxehtësisë së ndërtesave që ajrosen në mënyrë natyrore duhet të merret parasysh ripërtëritja e ajrit prej 2 vëllimeve në orë.

(a) Shpërndarja e nxehtësisë duhet të përfshijë:

- Një kthesë për sistemin horizontal të madh
- Izolimin, drenazhimin dhe valvulat rregulluese për secilin objekt
- Izolimin individual të gypave me material rezistente ndaj zjarrit në hapësirat që nuk ngrohen
- Temperatura maksimale e sipërfaqes që rekomandohet për materialet e ngrohura të qasshme është 60°C (e domosdoshme për klasat e nivelit parafillor).

(b) Dhoma e bojlerit:

- Duhet të ketë materiale rezistente ndaj zjarrit në pajtueshmëri me rregullat për mbrojtje nga zjarri;
- Nuk duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë me hapësirat publike;
- Të ketë një ndërprerës emergjent për energjinë elektrike dhe një ndërprerës emergjent për derivatet;

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	58

- Të ketë një dritë emergjente dhe fikës zjarri të cilët mund të mbahen me dorë;
- Matës të orëve, orë të ujit dhe alarm.

3.2.5 AJROSJA

Kushtet për sa i përket ajrosjes së dhomave janë si në vijim:

- Ajrosja natyrore përmes përdorimit të hapjeve të përhershme nuk rekomandohet;
- Aty ku është e zbatueshme, rrjedha e ajrit për ajrosjen mekanike nuk duhet të jetë më pak se 15m³/h për person;
- Niveli i zhurmës së ventilatorëve duhet të shqyrtohet me kujdes;
- Periudha e ajrosur duhet të jetë gjatë periudhës së shfrytëzimit plus një orë shtesë;

3.2.6 UJI I NGROHTË

Kushtet për sa i përket sistemit të ujit të ngrohtë janë:

- Temperatura e prodhimit dhe e ruajtjes nuk duhet të tejkalojë 60°C;
- Pajisjet e prodhimit duhet që të jenë sa më afër pikave të shfrytëzimit;
- Gypat dhe rezervaret e ujit të ngrohtë duhet të izoloohen me materiale rezistente ndaj zjarrit.

3.5 PROJEKTIMI PËR SIGURI

Duhet të ndërmerren masa të kujdesit për kufizimin e rreziqeve të aksidenteve dhe të zjarrit, si dhe të lëndimeve trupore në shkolla. Duhet të merren parasysh masat vijuese të kujdesit lidhur me peshën e rreziqeve:

3.5.1 HYRJA ME DHUNË, VJEDHJA, VANDALIZMI DHE ZJARRËVËNIA

Masat e projektimit kundër hyrjes së paautorizuar, vjedhjes dhe vandalizmit përfshijnë një numër veprimesh parandaluese që mund të ndërmerren në hapësirat shkollore për të zvogëluar rrezikshmërinë ndaj vendeve të caktuara, për të rritur nivelin e sigurisë dhe për të zvogëluar rrezikun nga përhapja e zjarrit. Këto në thelb janë instrumente për të ndihmuar menaxhimin e përditshëm të shkollës me qëllim të parandalimit apo të parashikimit të keqpërdorimit të pronës dhe rrjedhimisht, për ta zvogëluar ngarkesën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe ndikimin negativ të dëmtimeve të pavërejtura. Në këtë drejtim, mund të ndërmerren disa masa të thjeshta në fazën e projektimit për t'i kufizuar këto rreziqe. Këto masa kanë të bëjnë me si në vijim:

(a). Vendosja e objektit dhe plani i lokacionit

Projektimi i kujdesshëm i planeve të lokacionit mund ta përmirësojë dukshëm sigurinë në shkollë nëse do të kishte (i) **qasje të kufizuara në lokacionin e shkollës**, me mure rrethuese të lartësisë së mjaftueshme në zona specifike me dendësi banim (me lartësi së paku 2m) dhe me sipërfaqe të rrëshqitshme dhe të vështirë për t'u ngjitur), me mbrojtje përmes rrethojave të gjalla dhe gardeve, me numër të vogël të portave, me sisteme të alarmit, me kufizim të lëvizjes së mysafirëve; (ii) vëzhgim të lehtë të lokacionit, me ndërtesa që janë të ndërtuara ashtu që të kufizojnë hapësirat

e fshehta dhe me stacion të rojave apo me zyrë të pranimit të vendosura në vende strategjike; (ii) **qasje të kontrolluar në objekt**, me numër të kufizuar të dyerve hyrëse, me qasje të kufizuar në kulmet e rrafshëta, me grila të sigurisë në hapjet e katit përdhes, me ofrimin e dhomave të mbrojtura për vendosjen e gjërave të çmueshme (kompjuterëve, videove, materieve kimike, pajisjeve të laboratorit, librave të shtrenjta, etj) dhe me shmangien e kthinave dhe hyrjeve të fshehta;

(b). Ndriçimi i mjediseve dhe i hapësirave të jashtme

Pas orëve të mësimi, vendet e ndjeshme dhe pikat kyçe, siç janë hyrjet, kanë nevojë për ndriçim shtesë: ndriçimi i sigurisë zakonisht konsiderohet si parandalues i efektshëm ndaj dëmeve dhe ka kosto efektive. Pajisjet e ndriçimit duhet të jenë të paarritshme, përveç për qëllime të mirëmbajtjes. Ato duhet të mbrohen nga thyerjet, ndërsa pajisjet kontrolluese duhet të jenë larg tyre. Poçet e mbrojtura me metal apo plastikë të vendosura në objekt mund të jenë më pak të rrezikuara sesa ato të vendosura në shtylla por, nga ana tjetër, ndriçimi në shtyllë ka më pak gjasa të krijojë hije të fshehura. Ndriçimi i aktivizuar përmes lëvizjes, posaçërisht në vendet e pandriçuara mund të merret parasysh në rastet kur ndriçimi i përhershëm do të ishte i shtrenjtë. Ndriçimi gjatë natës i hyrjes dytësore rekomandohet për të lehtësuar vëzhgimin.

(c). Cilësia e materialeve të ndërtimit, ngjyrave dhe e pajisjeve

Projektuesit e ndërtesave shkollë duhet t'i parashohin vendet e rrezikuara dhe masat e mundshme korrigjuese. Për shembull: (i) sipërfaqet e mureve në korridore ku nxënësit qëndrojnë në rresht janë cak i shkrimeve në mur dhe i dëmtimeve të vogla; (ii) vendet si ato për pastrim, për

gardërobë dhe zhveshtoret mund të jenë caqe për sjellje të pahijshme dhe për fshehje të keqbërësve dhe (iii) dëmtimet në kulme dhe në rrethoja mund të rezultojnë nga nxënësit gjatë përpjekjeve për marrjen e topave të dalë jashtë hapësirës së shkollës.

Masat e thjeshta korrigjuese të propozuara në fazën e projektimit mund ta zvogëlojnë dukshëm nevojën për mirëmbajtje dhe riparime. Këto masa korrigjuese kanë të bëjnë me elementët vijues të ndërtimit: (i) mure, ndarje dhe llaqe të dyshemesë të lëmuara dhe të papërshtueshme me qëllim të heqjes së shkrimeve të mundshme në to (qeramika e lëmuar, tjegullat në formë mozaiku, laminati plastik, emali qelqor dhe çeliku i mbështjellë me PVC pastrohen lehtë); (ii) dyert nga materialet e forta dhe, nëse ka nevojë, të mbrojtura me pllaka të çelikut. Ata nuk duhet të kenë panele të lëmuara në pjesët e fundme dhe duhet të jenë të montuara në mënyrë të sigurt; (iii) pajisjet sanitare duhet të jenë të ngjitura mirë, ndërsa lidhjet e kanalizimit duhet të mundësojnë pastrimin e çdo pajisjeje me shkop ose purtekë; (iv) ndërtesat e lëmuara duhet të përzgjidhen në përputhje me nivelin e rrezikut dhe me aspektin e ndërrimit të tyre (qelq i pastër, qelq i telëzuar dhe qelq i laminuar...); (v) numri, lloji dhe madhësia e dritareve në katin përdhes dhe në vendet e tjera të qasshme duhet të merret parasysh nivelin e kërkuar të sigurisë; (vi) kabllot dhe përçuesit elektrikë duhet të fshihen sa më shumë që është e mundur, dhe pajisjet elektrike duhet të jenë mirë të instaluar për të parandaluar apo dekurajuar vandalizmin.

Përveç kësaj, projekti i ndihmon menaxhmentit të paraparë të shkollës, duke ofruar dhoma specifike për depo dhe të kyçura, për t'u siguruar që materialet dhe pajisjet, që mund të përdoren për bërjen e dëmeve, siç janë shportat e mbeturinave (mund

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	60

t'u vihet flaka], shkallët (mund të përdoren nga hajnat) dhe materialet lehtë të djegshme të jenë larg nga qasja e nxënësve dhe hajnavë të mundshëm.

3.5.2 AKSIDENTET

Rreziqet lidhur me aksidentet në komplekset shkollore kanë kryesisht të bëjnë me pesë rreziqe potenciale të lëndimit ndaj nxënësve dhe personelit. Këto janë:

- Aksidentet e trafikut në hyrje dhe dalje të kompleksit shkollore;
- Rrëzimet dhe lëndimet në terrenet për lojë dhe në ato sportive;
- Rrëzimet në ndërtesat për shumë qëllime apo nga to;
- Aksidentet në laborator: kemikaljet, djegiet, etj. dhe
- Aksidentet në punëtori (veglat, makineria, etj për hapësirat profesionale dhe teknike)

Masat që projektuesit e ndërtesave shkollore duhet t'i ndërmarrin për të parandaluar aksidentet dhe lëndimet kanë të bëjnë me aspektet vijuese:

(a) Lokacionin e shkollës dhe qasjen e saj

Lokacioni i shkollës duhet të gjendet sa më larg që është e mundur nga vendet me rrezikshmëri të aksidenteve (autostradat, stacionet hekurudhore) dhe nga zjarret (punëtoritë, fabrikat, depot, pompat e benzinës). Rruga hyrëse për në shkollë duhet të jetë së paku 8 m e gjerë dhe e përshtatshme për vetura dhe kamionë, duke përfshirë autoambulancat dhe automjetet e zjarrfikësve.

Për t'iu shmangur tolloive në komunikacion dhe pengimit të qarkullimit, si dhe për të garantuar sigurinë e nxënësve, të personelit, të prindërve dhe të mysafirëve që shfrytëzojnë vetura, duhet të projektohet vendi i ndalesës së tyre para portës kryesore. Përveç kësaj, duhet të ndërtohet një hapësirë e madhe e shtruar

apo trotuar në hyrjen kryesore të shkollës me qëllim të zvogëlimit të rrezikut për aksidente të trafikut me rastin e hyrjes apo daljes së nxënësve nga kompleksi shkollore. Hapësira e shtruar duhet të jetë së paku 4.0 m e gjerë dhe nuk duhet të ketë pengesa (kioske, automjete) që do të mund të pengonin lëvizjen e nxënësve. Sa i përket rrugës, aty duhet të përfshihen edhe autoritetet lokale përmes vendosjes së policëve të shtrirë, shenjave të komunikacionit dhe tabelave njoftuese.

(b) Komponentët e qarkullimit

Për të parandaluar rëniet nga ndërtesat shumëkatëshe, galeritë e hapura dhe shkallët duhet të kenë parmak së paku 1.05 m të gjatë. Materialet e përdorura duhet të jenë rezistente dhe të qëndrueshme me maksimum 11.0 cm largësi mes shtyllave të parmakut.

Preferohet që shkallët të jenë të një dizajni të thjeshtë, me dy rampa të shkallëve dhe një sheshpushim mes secilit nivel dhe qasja për në kulm duhet të mbyllet dhe të jetë e qasshme vetëm për personelin e mirëmbajtjes. Secila rampë e shkallëve duhet të jetë mjaft e gjerë për të mundësuar kalimin e së paku dy personave lart dhe poshtë shkallëve. Shkelësit e basamakut duhet që sipër të jenë prej materialit jorrëshqitës dhe duhet të shënohen në skaje.

Për rekomandime të tjera për sa i përket madhësisë, largësisë maksimale dhe lokacionit të shkallëve dhe korridoreve, shih paragrafin 3.4.3 në vijim mbi sistemet e mbrojtjes nga zjarri.

(c) Hapësirat e mbjella

Është e rëndësishme që projektuesit dhe menaxherët e shkollave të lejojnë një largësi të mjaftueshme mes drunjve dhe ndërtesave të kompleksit të shkollës (së paku 5.0 m). Gjithashtu rekomandohet të bëhet krasitja e pjesëve të poshtme të drunjve për të parandaluar ngjytjen e nxënësve dhe dekurajimin e personave të hyjnë nga jashtë.

(d) Teknikat dhe materialet ndërtimore

Projektuesi është përgjegjës për përzgjedhjen e materialeve dhe teknikave ndërtimore që do të ulnin rreziqet e aksidenteve. Për shembull (i) mbulojat e dys-hemesë duhet të mos jenë të rrëshqitshme dhe duhet të jenë pa pengesa; (ii) duhet të merret parasysh mbrojtja kundër objekteve që mund të bien në rastin e ndërtesave shumëkatëshe; (iii) rezistenca e ndarjeve dhe e qelqit ndaj tronditjeve duhet të studiohet me kujdes në lidhje me rreziqet nga aksidentet e sipërfaqes së caktuar, rekomandohet shumë që të përdoret qelqi i përforcuar; (iv) këndet e mureve duhet të jenë të formës qarkore së paku deri në 2.0 m lartësi; (iv) gypat e ujit, gazit dhe të rrymës duhet të jenë të ndarë dhe të jenë të mbrojtur mirë; (v) pajisjet elektrike, paneli shpërndarës dhe rrjetet elektrike duhet të vendosen në vende të sigurta për të mënjeluar çdo lloj rreziku nga rryma apo zjarri; dhe (vi) secila ndërtesë duhet të kenë mbrojtje të plotë nga vetëtimja.

3.5.3 SISTEMET DHE RREGULLAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Në Kosovë normat dhe rekomandimet teknike për mbrojtjen e ndërtesave nga zjarri ende nuk janë përcaktuar, dhe profesionistët nga sektori i ndërtimtarisë mbështeten në normat e shteteve të tjera, kryesisht të shteteve të BE-së, të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe/ose të Shteteve të Bashkuara. Megjithatë, në vitin 2006 është miratuar një Ligj i mbrojtjes nga zjarri (ligji nr. 02/L-41 i datës 27 prill 2006), përmes të cilit paraqiten rregullat kryesore, masat dhe orientimet e sistemit të mbrojtjes nga zjarri në Kosovë.

Masat paraprake që duhet të ndërmerren nga projektuesit e shkollave përfshijnë një grup masash për kufizimin e rreziqeve nga zjarri, lehtësimin e evakuimit të shfrytëzuesve të ndërtesave dhe lehtësimin e qasjes së ekipeve të shpëtimit. Kjo përfshinë metoda të ndryshme të mbrojtjes dhe sisteme të sigurisë ndaj zjarrit të cilat

janë përshkruar shkurtimisht në vijim:

(a) Qasja në lokacion

Për sa i përket mbrojtjes nga aksidentet, lokacioni i shkollës duhet të vendoset sa më larg që është e mundur nga zonat që paraqesin rrezik nga zjarri (punëtoritë, fabrikat, depot, pompat e benzinës...), dhe rruga e qasjes për në ndërtesa duhet të jetë, së paku, 8.0 m e gjerë (të shqyrtohet me shërbimet lokale të shpëtimit) dhe duhet të jetë e përshtatshme për vetura dhe kamionë, përfshirë ambulancat dhe automjetet e shpëtimit të zjarrfikësve.

(b) Komponentët e qarkullimit**(i) Qasja e automjeteve dhe e personelit për shërbime emergjente:**

rregulloret për fikje të zjarrit parashohin rregulla rigoroze që duhet të zbatohen në projektimin e shkollave për sa i përket qasjes në shkollë nga ekipet e shpëtimit dhe të zjarrfikjes. Qasja e automjeteve në pjesën e jashtme të ndërtesës është e nevojshme për të mundësuar funksionimin e mjeteve që mbërrijnë në lartësi, siç janë shkallët rrotulluese dhe platformat hidraulike që duhet të përdoren dhe për të mundësuar mjetet e pompimit që të furnizojnë me ujë dhe funksionimin e pajisjeve për zjarrfikje dhe veprimtaritë e kërkimit dhe shpëtimit. Kushtet për qasje shtohen me madhësinë dhe lartësinë e ndërtesës: kjo ka të bëjë me gjerësinë minimale të rrugëve të qasjes, largësinë mes rrugëve dhe ndërtesave, dimensionet e rrugëve, ndërtesat rrotulluese në rrugët qorre...

(ii) Mënyrat e daljes: parimi i parë dhe themelor është siguri i mënyrave alternative të daljes. Kjo siguron që njerëzit gjithnjë të kenë mundësinë të kthehen dhe të largohen nga ndonjë zjarr, përveç në distancat shumë të shkurta në fillim të evakuimit të tyre nëse ata ndodhen shumë afër zjarrit. Një nga mënyrat kyçe që ud-

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	62

hëzimi i projektimit parasheh mënyra adekuate të daljes është përmes caktimit të kufijve të lartë në distancën e rrugës për në katin tjetër apo për në daljen e fundit. Për shembull, në ndërtesat shumëkatëshe, distanca maksimale gjer te shkallët është 20.0 m. Si rezultat i kësaj, distanca maksimale mes dy rampave të shkallëve nuk duhet të jetë jo më shumë se 40.0 m. Por, në varësi prej nivelit të rrezikut; numrit të rrugëve të evakuimit dhe mënyrës së organizimit të hapësirave distanca maksimale e evakuimit mund të sillet prej 12-45 m.

- (iii) **Gjerësia e qarkullimeve** (dyert, korridoret dhe galeritë) përcaktohet nga numri i shfrytëzuesve (shih paragrafin 2.2.28 të Vëllimit 1): korridoret duhet të jenë mjaft të gjerë për të mundësuar evakuimin e shpejtë, të sigurt dhe të lehtë të ndërtesave dhe asnjëherë nuk mund të jenë më të ngushtë se 1.5 m për qarkullime me ngarkesa të vetme dhe 1.8 m për qarkullime me ngarkesa të dyfishta (shih tabelën 2.1 të Vëllimit 1).

(c) **Elementet dhe materialet e ndërtesës**

- (i) Performanca për sa i përket **rezistencës së materialeve** dhe elementeve të ndërtesës matet nga aspekti i (i) rezistencës ndaj **shembjes** ose kapacitetit të bartjes së ngarkesave që zbatohet vetëm për elementet e bartjes së ngarkesave (që shënohet me "R" në klasifikimin evropian); (ii) rezistencës së **depërtimit të zjarrit** ose integritetit (shënohet me "E"); dhe (iii) rezistencës ndaj **bartjes së nxehtësisë së lartë** ose izolimi (shënohet me "I").
- (ii) Projektuesit e shkollave do të duhet t'i referohen rregulloreve ekzistuese për mbrojtje nga zjarri të cilat paraqesin rregullat dhe kriteret për **përzgjedhjen e materialeve** për secilin element të objektit (strukturat, muret, ndarjet, tavanet, kulmet, hapjet dhe qelqi), varësisht nga lartësia

e ndërtesës, shfrytëzimi i saj dhe pozita e elementit të caktuar në skemën e fikjes së zjarrit.

(iii) **Tubacionet dhe hidrantët e fikjes së zjarrit:**

tubacionet e fikjes së zjarrit instalohen nëpër ndërtesa dhe pajisjen me valvula në mënyrë që shërbimet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit të mund të lidhin tubat për ujë për të fikur zjarrin brenda ndërtesës. Ato mund të jenë të llojit "të thatë" që zakonisht janë të zbrazëta dhe furnizohen përmes një tubi nga pajisjet pompuese të shërbimit të zjarrfikjes dhe të shpëtimit, ose të jenë edhe të llojit të "lagësht" ku ato mbahen me plot ujë dhe furnizohen nga rezervaret dhe pompat në ndërtesë. Duhet të ekzistojë edhe një pajisje për t'i mundësuar sistemit të lagësht që të rimbushet nga pajisjet e pompimit në rast të emergjencave.

(d) **Pajisjet e fikjes së zjarrit**

- (i) **Hetimi automatik i zjarrit:** Zbulimi i hershëm automatik dhe alarmimi i zjarrit ndihmojnë në daljen e shpejtë dhe të sigurt të personave, apo e trajtojnë zjarrin kur ai gjendet në fazën e parë të zhvillimit. Kjo do të mundësojë thirrjen e ndihmës profesionale pa ndonjë vonesë gjë që do të ulte dëmtimet e shkaktuara të ndërtesës dhe përmbajtjes së saj. Shembuj të këtyre pajisjeve përfshijnë pajisjet mbaj-dhe-hap të dyerve kundër zjarrit, sistemet e nxjerrjes së tymit apo sistemet e ajrosjes, sistemet e presimit dhe valvulave të zjarrit në tubacionin e ajrosjes.
- (i) **Shenjat dhe njoftimet:** Të gjitha shenjat dhe njoftimet duhet të vendosen në mënyrë që ato të shihen dhe të kuptohen me lehtësi. Shenjat duhet të përdoren, aty ku është e nevojshme, për t'ju ndihmuar personave që t'i identifikojnë rrugët e daljes dhe daljet, të gjejnë pajisjet e zjarrfikjes dhe telefonat emergjent në rast të zjarrit. Lajmërimet duhet të përdoren, aty ku

■ LLOJET DHE PËRDORIMI I FIKËSVE TË ZJARRIT

Kategoria e zjarrit	Materialet/produktet e përfshira	Lloji i fikësve të zjarrit	Lokacioni në shkollë
Kategoria A	Materialet e ngurta, si druri, letra apo tekstili	Uji	Hapësirat e projektimit dhe të teknologjisë Binat e seciliës hapësirë për shumëqëllime Zonat e banimit të shkollave me konvikte Në rrugët e daljes, në mënyrë që distance në këmbë deri tek fikësi i pare të mos tejkalojë 30m
Kategoria B	Lëngjet e ndezshëm, si benzina, nafta apo vajrat	Shkuma apo pudra e thatë	Laboratorët, teknologjia e ushqimit, kuzhinat
Kategoria C	Gazrat	Kemikaljet e lëngshme	Kuzhinat/teknologjia e ushqimit për zjarret e thella të yndyrës
Kategoria D	Metalet	Shkuma	Dhomat e bojlerëve ku përdoren derivatet e vajit
Kategoria F	Vaji i kuzhinës/ vajrat me shumë yndyrë	Dyoksid karboni apo pudra e thatë	Dhomat e ndërprerësve elektrik dhe vendeve ku janë të pranishme pajisjet e rrymës, p.sh. zonat e kontrollit të ndriçimit dhe sallat ICT
	Automjetet	Pudra e thatë	Mbrojtja e automjeteve

TABELA 3.6

është e nevojshme, për të dhënë udhëzime se si të përdoren pajisjet kundër zjarrit, rreth veprimeve që duhet të ndërmerren në rast të zjarrit dhe informatave rreth shërbimit kundër zjarrit dhe të shpëtimit.

- (ii) **Ndriçimi emergjent:** ndriçimi emergjent nevojitet për të treguar dhe ilustruar në mënyrë të qartë rrugët dhe shenjat e daljes, përfshirë këtu rrugët e daljes që janë jashtë ndërtesës, për të siguruar që ndryshimet e kateve dhe të drejtimeve të tregohen dhe për të siguruar që pikat e thirrjes së alarmit të zjarrit dhe pajisjet e zjarrfikjes të mund të gjenden me lehtësi.
- (iii) **Kontrolli i tymit:** ekzistojnë katër arsye kryesore për kontrollimin e shpërndarjes së tymit, që janë, mbrojtja e rrugëve të daljes, asistimi i fikjes së zjarrit, kufizimi i rrezikut ndaj shfrytëzuesve të objektit në sallat që nuk janë në afërsi të zjarrit dhe minimizimi i dëmit nga tymi ndaj përmbajtjes së ndërtesës. Në shumicën e

rasteve kjo arrihet përmes përdorimit të masave të përmbajtjes, siç janë dyert dhe muret. Megjithatë në disa rrethana sistemet e ajrosjes të tymit apo sistemet e shtypjes mund të jenë të nevojshme apo të dëshirueshme.

- (iv) **Ndihma e parë e zjarrfikjes:** fikësit e zjarrit duhet të përmbushin funksionin për sigurinë e jetës nëse mënyra më e sigurt e ikjes nga efektet e zjarrit është fikja e tij. Ata gjithashtu kanë një rol të dukshëm në mbrojtjen e pronës, nëse zjarri mund të luftohet para se të bëhet shumë i madh. Llojet e ndryshme të fikësve të zjarrit përdoren për llojet e ndryshme të zjarrit: në tabelën 3.6 më poshtë janë paraqitur llojet kryesore të fikësve të zjarrit, llojet e zjarrit për të cilët ata janë të përshtatshëm dhe lokacionin e përgjithshëm të pajisjeve të zjarrfikjes.

Kur rreziku nga zjarri nuk është i kufizuar në ndonjë lokacion të caktuar, p.sh. zjarret e kategorisë A, fikësit e zjarrit duhet të vendosen në rrugët e daljes, afër daljes

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	64

nga dhoma apo në dysheme, apo në daljen e fundit nga ndërtesa.

- (v) Sistemet e spërkatjes: Sistemet e spërkatjes përfshijnë njehsorët e rrjedhjes të lidhur me alarme, dhe nëse instalohet një sistem i fikjes së zjarrit në tërë ndërtesën do të kenë një bonus shtesë që janë hetuesit e nxehtësisë në tërë shkollën që mund të shpijnë në kursime të përgjithshme. Megjithatë, ky sistem mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe projektuesi mund të duhet të zgjedhë një tipar të kufizuar të kompensimit për të trajtuar rreziqet specifike përmes mbrojtjes së vetëm një ndërtese apo vetëm ndonjë pjese të ndërtesës.
- (vi) Kufizimi i përhapjes së zjarrit: ndërtimi rezistues ndaj zjarrit dhe tymit ka tri objektiva kryesore: (i) parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe të tymit në rrugët e mbrojtura, pra në korridoret dhe shkallët e mbrojtura; (ii) izolimin e zonave ku vlerësimi i rrezikut ka identifikuar zona të rrezikshme apo zona të identikuara si thelbësore për funksionimin e shkollës dhe (iii) kufizimin e dëmeve joproporcionale ndaj shkollës si rezultat i ndonjë zjarri përmes ndarjes apo kufizimit të zjarrit në vendin ku ai nis.
- (vii) Dyert kundër zjarrit: dyert e vendosura në muret rezistuese ndaj zjarrit apo në muret ndarëse duhet të jenë dyer kundër zjarrit, të dizajnuara që të rezistojnë kalimin e zjarrit dhe të tymit. Dyert e zjarrit përdoren në rrugët e daljes për të ndarë korridoret e gjata duke siguruar kështu që jo më shumë se një pjesë e shkurtë e korridorit që shpie në dalje të mbushet me tym gjatë ndonjë zjarri. Dyert e zjarrit duhet të përdoren për të ndarë shkallët nga rrugët e qarkullimit në mënyrë që shkallët të mbrohen nga hyrja e tymit.

Dyert e zjarrit në përgjithësi do të kenë panele të qelqit për t'i ndihmuar shfrytëzuesve për të parë më tej, përfshirë ata me nevoja të veçanta, gjatë lëvizjes së tyre

. Panelet e pamjes gjithashtu do të jenë të dobishme në rast të zjarrit për t'ju mundësuar njerëzve që të shohin nëse hapësira nga ana tjetër është prekur nga tymi apo jo. Përdorimi i qelqit varet në atë nëse ai ofron izolim si dhe integritet për nivelin e duhur të rezistencës ndaj zjarrit për së paku 60 minuta..

3.5.4 SHKATËRRIMI ME KALIMIN E KOHËS DHE FATKEQËSITË NATYRORE

(a) Shkatërrimi me kalimin e kohës

Duhet të parashihen dispozita edhe rreth kufizimit të rreziqeve nga dëmet dhe shkatërrimet e ndërtesave dhe pajisjeve, meqë mungesa e masave mbrojtëse mund të zvogëlojë kohëzgjatjen e dobishme të të dyjave dhe/apo të shkaktojë riparime të shtrenjta. Dy shkaktarët kryesor të prishjeve, përveç amortizimit, janë moti dhe agentët e ndryshëm biologjik:

(i) **Moti:** faktorët klimatik kanë një ndikim serioz në ndërtesat shkollore nëse ata nuk trajtohen me kujdes në fazën e projektimit, në veçanti në tiparet e jashtme siç është izolimi, izolimi nga uji, drenazhi i ujit nga kulmi, pozita e dyerve dhe dritareve, parvazet dhe strehët e dritareve, etj. Efektet e prishjeve të ndërtesave dhe pajisjeve kryesisht shkaktohen nga:

- Ndriçimi intensiv i diellit dhe rrezatimet e diellit (sipërfaqet e jashtme);
- Lagështia, në veçanti gjatë dimrit (struktura dhe sipërfaqet, elementet e drurit dhe oksidimi i kornizave të metalit);
- Rëra dhe erërat me pluhur (shtresa, hapjet dhe pajisjet e jashtme);
- Elementet kimike në zonat urbane dhe kripa në atmosferë (shtresat, ngjyrosjet dhe strukturat metalike);
- Shirat dhe stuhitë e fuqishme (kulmi dhe hapjet)

(ii) **Agentët biologjikë:** insekte të caktuara, siç janë termitet, milingonat apo merimangat, kafshët e vogla, si

zogjtë dhe brejtësit, si dhe kërpudhat që rezultojnë nga kombinimi i errësirës, nxehtësisë dhe lagështisë janë faktorë degradues për ndërtesat, materialet dhe pajisjet, dhe shkaktojnë zvogëlimin e kohëzgjatjes së dobishme të ndërtesave shkollë. Përveç kësaj, këta agjentë kanë ndikime të dëmshme në shëndetin, sigurinë dhe komoditetin e shfrytëzuesve (shih paragrafin 3.3.6 më lartë).

(iii) **Mbrojtja kundër shkatërrimit** përfshinë masat e thjeshta që lehtësisht mund të inkorporohet gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit. Këto masa përfshijnë:

- Pastrimin e lokacionit pasa fillimit të ndërtimit;
- Përdorimin e materialeve rezistente ndaj termiteve (druri) dhe ndaj ndryshkut (metali);
- Përzgjedhjen e sipërfaqeve të sipërme të ngurta dhe që mund të pastrohen;
- Trajtimin e elementeve të drurit me produkte kundër këpurdhave dhe insekteve;
- Mbylljen apo mbrojtjen e të gjitha hapësirave që mund të lejojnë qasjen e kafshëve dhe insekteve (nyjat, gypat, hapjet e ajrosjes, etj.);
- Ajrosjen e mirë dhe ndriçimin natyror të zonave të depove për të parandaluar rritjen e kërpudhave;
- Shtrëngimin rigoroz të gypave për të shmangur rrjedhjet dhe akumulimin e ujit që mund të tërheqë kafshë dhe insekte;

(b) Tërmetet

Ky paragraf trajton kushtet e parapara për ruajtjen e integritetit të strukturave të ndërtesës së shkollës kur ajo i nënshtrohet një tërmeti të intensitetit të mesëm ose të lartë. Normalisht, në përputhje me kodet dhe rregulloret e objektit, strukturat janë projektuar të "përballojnë" tërmetin më të madh që ka të ngjarë të ndodhë në lokacionin e dhënë. Kjo do të thotë se humbja e jetëve dhe e pronës duhet të minimizohet duke parandaluar shembjen e ndërtesave.

Zakonisht, **kushtet sizmike të projektimit** caktohen në varësi të rregulloreve të lokacionit/lokalitetit ku realizohet projekti dhe të autoriteteve të saj të cilat përcak-

tojnë kodet dhe kriteret e aplikueshme të projektimit sizmik. Mirëpo, normat dhe rekomandimet për projektimin sizmik të ndërtesave ende nuk janë të përcaktuara në Kosovë, megjithëse vendi ndodhet në një zonë sizmike, ndërsa profesionistët e sektorit të ndërtimit po mbështeten në normat e përcaktuara nga ligjet e mëhershme apo vendet e huaja, kryesisht nga vendet e BE-së dhe të OECD-së dhe/ose nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Energjia e valëve sizmike të terrenit që puqen në bazën e një ndërtesë, për shkak të lëkundjeve, zvogëlohet në mënyrë dramatike. Mirëpo, pjesët e mbetura të valëve rënëse gjatë tërmetit kryesor ende bartin një potencial të madh shkatërrues. Me hyrjen e valëve sizmike në superstrukturën e ndërtesës, ekzistojnë tri masa kryesore për t'i kontrolluar ato për të zbutur efektet e tyre. Ato janë:

- Rritja e kapacitetit të ndërtesave për të mënjanuar energjinë sizmike;
- Lehtësimi i shpërndarjes së energjisë së valës brenda superstrukturës; dhe
- Shpërndarja e energjisë së valës ndërmjet një game më të gjerë të frekuencave.

Përveç kushteve të projektimit për vetë strukturën, kushtet tjera mund përfshijnë punën që bëhet nën strukturën e ndërtesës për stabilizimin e dheut për të siguruar që, dheu që lëkundët furishëm të mos nxisë shembjen e strukturës që është e vendosur mbi të.

Objektivat kryesore të këtyre masave që duhet të merren parasysh nga projektuesit e shkollave kanë të bëjnë me (i) ruajtjen e jetëve njerëzore dhe të pronës; (ii) zvogëlimin e dëmit; dhe (iii) garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të shkollës.

Për t'i arritur këto objektivat, projektuesit duhet të kenë parasysh masa specifike me qëllim të përmirësimit të përballimit të tërmeteve nga ana e ndërtesave. Këtu hyjnë rregulla dhe rekomandime të thjeshta të cilat duhet të respektohen nga projektuesit, sidomos në përzgjedhjen e teknikave dhe të materialeve të ndërtimit, siç janë:

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	66

(i) Projektimi arkitektonik

- Projektimi i ndërtësive të thjeshta, nëse është e mundur monolite, duke shmangur format e parregullta dhe/ose të nyjzuara, si në plan, ashtu edhe në ngritjen e tyre;
- Shmangia e hapjeve të gjera në panelet e pam-bushura me beton që mund të shkaktojnë parregullsi në plan (efektet rrotulluese) dhe në ngritje duke krijuar vende-vende dobësi dhe papërbalueshmëri në aspektin e kërkesës për elasticitet;
- Shmangia e lartësisë së tepruar mes-kateve, që zakonisht shihet në strukturat e gjimnazeve dhe të teatrove, gjë që e rrit fleksibilitetin e strukturës dhe rrezikun nga shembja e paneleve të pam-bushura në strukturat e përforcuara me beton;
- Shmangia e pjesëve të mëdha të dala, elementeve të tepruara dekorative, gjërave të panevojshme prej betoni...

(ii) Projektimi teknik:

- Sigurimi i izolimit sismik sa herë që është i nevojshëm;
- Projektimi i trarëve të unazuar të përforcuar plotësisht nga betoni;
- Sigurimi i hallkave të forta ndërmjet pllakave dhe shtyllave të betonit;
- Ngritja e nyjave të gjera anti-sizmike për t'i ndarë strukturat komplekse në disa pjesë;
- Shmangia e parregullësisë në formë që shpesh ka për pasojë parregullsitë strukturore, duke i dhënë kështu një veçori të pafavorshme ndërtësive në zonat sizmike;
- Shmangia e këndeve të forta dhe ndryshimeve në drejtim - në strukturën që e bart ngarkesën;
- Shmangia e depërtimeve të boshteve ose hyrjeve të mëdha në muret që bartin ngarkesën;
- Shmangia e sistemeve të përziera, si me shtylla dhe mure që bartin ngarkesën e peshës;
- Shmangia e variacioneve të papritura në pjesët e strukturës (shtylla, mure).

(iii) Cilësia e ndërtimit:

- Respektimi i standardeve të larta të ndërtimit me mbikëqyrje dhe kontroll të përforcuar të punëve;
- Sigurimi i mirëmbajtjes së rregullt dhe efektive të elementeve strukturore.

(iv) Themelet

- Përshtatja e themeleve me tipin gjeologjik të dheut;
- Shmangia e dridhjeve të rëndomta të valëve sizmike të tokës me ato që kalojnë përmes ndërtësive, me qëllim të ndërprerjes së fenomenit të përforcimit të valëve.

(c) Mbrojtja nga rrufetë

Sistemi për mbrojtje nga rrufetë është një masë e rëndësishme mbrojtëse që duhet të kihet parasysh nga projektuesit e shkollave. Sistemi është i projektuar për të mbrojtur ndërtësat dhe përmbajtjen e tyre nga dëmtimi për shkak të goditjeve, duke i ndërprerë ato dhe duke e përcjellë pa rrezik rrymat e tyre të tensionit të lartë në tokë. Shumica e sistemeve për mbrojtje nga rrufetë përmbajnë në vete një rrjet të përbërë nga tri elemente. Ato janë:

- shufrat rrufepritëse** ose terminalet ajrore që zakonisht janë të vendosura në ose përgjatë pikave më të larta të strukturës së kulmit, dhe të lidhura elektrikisht me njëra tjetrën përmes përçuesve të lidhur;
- përçuesit metalik të vendosur teposhtë** që gjithashtu quhen "të drejtuar teposhtë", të cilët janë të lidhur në rrugën më direkte për te njëri ose më shumë vendshkarkues në tokë. Lidhjet për elektrodën e vendosura në tokë nuk duhet të kenë vetëm rezistencë të ulët, por duhet të kenë edhe vetë-induktancë të ulët;
- elektrodat e tokëzimit** ose "tokëzimi" i bërë nga shufrat, pllakat metalike ose rrjetat.

(d) Vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut

Mbrojtja nga vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut fillon me përzgjedhjen e duhur të lokacionit që nuk përmban rrezik fare, ose rrezik minimal nga vërshimet ose rrëshqitjet e dheut, dhe kjo mund të plotësohet me masa specifike që përshtaten për secilin lokacion, të bazuar në anketat lokale dhe testimet e dheut me numër, thellësi dhe lokacion adekuat të shpimeve të dheut.

Mirëpo, nëse lokacioni i shkollës është në një "zonë A" (afër ndonjë lumi, përroske ose liqeni), dhe katet e ulëta të projektuara janë më poshtë se baza e ngritjes së vërshimit, mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga dëmi i shkaktuar nga vërshimi është që të ngriten ndërtesat ashtu që kati më i ulët të jetë i barabartë, ose të jetë mbi bazën e ngritjes së vërshimit. Projektuesi po ashtu mund t'i merr edhe këto masa për të shmangur ose zbutur dëmet nga vërshimi në një zonë të tillë:

- Shfrytëzoni materiale ndërtimore rezistuese ndaj ujit në zonat më poshtë se baza e ngritjes së vërshimit;
- Mos e parashihni bodrumin ose katet e ulëta, nëse ato janë më poshtë se baza e ngritjes së vërshimit;
- Pengoni linjat e kanaleve të ujërave të zeza dhe ato të kullimit nga mbështetja, përmes instalimit të valvuleve pompuese për thithje të ujit ose tubave vertikal;
- Vendosni pajisjet e ndjeshme si nxehësi i ujit, rezervuarët e karburantit, bojleri dhe telat e rrymës elektrike në blloqet e betonit, mbi bazën e nivelit të ngritjes së vërshimit. Nëse nuk ka mundësi të ngritni ndonjë nga këto, vendosja aty dhe mbrojtja me një mur ose mburojë nga vërshimi duhet të merret në konsideratë;
- Instaloni mburoja kundër vërshimit ose pengesa të përforcuara për dritaret dhe dyert e bodrumit. Pjesët e sipërme të mburojave dhe të pengesave duhet të jenë më të larta se baza e nivelit të vërshimit;

- Instaloni dhe mirëmbani një sistem me pompë thithëse, nëse ka kate që janë nën nivelin e vërshimit; dhe
- Mbillni bimë dhe vegjetacion tradicional që e mbrojnë tokën nga erozioni.

3.6 MIRËMBAJTJA

Problemi i mirëmbajtjes së ndërtesave fizike është universal dhe marrja parasysh e këtij problemi në fazën e projektimit është me rëndësi jetike: në fazat e hershme të projektimit të cilësdo ndërtesë, duhet të vendoset, përveç sasisë së hapësirës së nevojshme, kohëzgjatja e dëshiruar e ndërtesës dhe shuma e parave që duhet të shpenzohet si për shpenzimin e gjithëmbarshtëm dhe në mirëmbajtje.

Gjatë përgatitjes së projektimit, duhet të merren vendime sa i përket shpenzimeve kapitale sa i përket riparimit vjetor dhe koston e zëvendësimit, si dhe kohëzgjatjes përfundimtare që pritet të ketë një ndërtesë. Këto vendime do të kenë efekte jetike në masën e mirëmbajtjes që do të kërkojnë ndërtesat e reja gjatë kohëzgjatjes së tërësishtme të shfrytëzimit të tyre. Duhet të kuptohet qartë se kostoja më e ulët fillestare nuk është më ekonomike në afatgjatë, pasi që shumë materiale të lira do të kërkojnë shumë më shumë mirëmbajtje dhe mund të kenë afat më të shkurtër funksionimi sesa disa të tjera që janë më adekuate, por që janë alternativa më të shtrenjta. Për shembull, kjo është posaçërisht e vërtetë për mbarimet e mureve dhe të kateve të cilat i nënshtrohen harxhimit dhe brejtjes së vazhdueshme.

Vendi i parë për t'i parandaluar defektet dhe zvogëluar nevojat për mirëmbajtje është në përgatitjen e një **projekti fillestar** të përshtatshëm, dhe për ta arritur këtë, sistemit të mirëmbajtjes duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi në projektimin e të gjitha shkollave të reja. Inxhinierët dhe teknikët e mirëmbajtjes duhet të konsultohen në secilën fazë të ngritjes së

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	68

konstruksioneve të reja. Ata duhet t'i kontrollojnë këto pika:

- (i) Në fazën e planifikimit: **madhësitë, sasitë dhe performancat** e hapësirave duhet të përkojnë me detyrat dhe përdorimin e tyre real. Kjo duhet të pasqyrohet në përmbledhjet e projektit dhe të kontrollohet para nisjes së fazës së projektimit. Për shembull, numri i kabinave të tualetit që duhet të përkojë me numrin real të nxënësve (rrreth 30 nxënës për një dhomëz tualeti). Në të kundërtën, përdorimi tejmasë i kabinave të tualetit do të nxisë përkeqësim të shpejtuar të të gjitha elementeve (të sistemit gypave të kanalizimit, lëshuesve të ujit, dyerve, rezervuarëve septikë dhe gropëzat e WC-ve) me, mes tjerash, bllokimin e shpeshtë të kanalizimit;
- (ii) **Analiza e kostos-përfitimit** duhet të përgatitet, duke marrë parasysh koston e vlerësuar të mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese gjatë ciklit jetësor të një ndërtese. Specialistët e mirëmbajtjes duhet të jenë të aftë të rekomandojnë modifikime nëse kostoja e mirëmbajtjes është tepër e lartë, krahasuar me koston e investimit.
- (iii) Në fazën e projektimit të projektit, **zgjedhja e materialeve**, teknikat e montimit dhe të konstruktimit duhet të kontrollohen përmes përdorimit të kriterit të balancimit të koston, komoditetit, qëndrueshmërisë strukturale, etj.. Për shembull, shfrytëzimi i kapakëve për pesha të rënda, lëshuesve të ujit dhe gropëzave është domosdoshmëri nëpër shkolla kur të gjitha këto elemente shpesh anashkalohen;
- (iv) Gjatë fazës së projektimit, **specifikacionet** për të gjitha elementet e ndërtesës duhet të kontrollohen, duke paratur parasysh, sasinë e punëve të mirëmbajtjes që duhet të sigurohen gjatë ciklit jetësor të secilit element;
- (v) Gjatë zbatimit, duhet të sigurohet **mbikëqyrje** efektive gjatë gjithë fazës së konstruksionit. Mbikëqyrësve duhet t'u jepet fleksibilitet i mjaftueshëm për të qenë në gjendje t'i korrigjojnë të gjitha defektet para certifikimit përfundimtar.

3.7 ORENDITË DHE PAJISJET

Planifikimi dhe projektimi i orendive dhe i pajisjeve të shkollave nuk është pjesë e këtyre udhëzimeve të përgjithshme, por meqë karakteristikat dhe dimensionet e tyre luajnë një rol të madh në përcaktimin e dimensioneve dhe në konfigurimin e dhomave, është e nevojshme të kihet parasysh aspekti dimensional i tyre si një element i projektimit të ndërtesës, sidomos për definimin e dimensioneve të dhomave dhe të hapësirës së sipërfaqes, vendndodhjes dhe dimensioneve të dyerve dhe të dritareve...etj..

Përveç tjerash, shumica e pajisjeve të fiksuara siç janë tabelat e shkrimit, dollapë të vendosur, raftet, ulëset dhe lavamanet e laboratorit...etj, shpesh janë pjesë e kontratave të punëve civile dhe si rrjedhojë projekti dhe specifikimet e tyre duhet të përgatiten nga projektuesit e ndërtesës.

Për qëllime praktike dhe për t'ju drejtuar furnizuesve të caktuar, orenditë dhe pajisjet e shkollave zakonisht ndahen në pjesë, si vijon:

- (i) **Orenditë e përgjithshme** arsimore për klasat (bankat (tavolinat) dhe karriget e nxënësve, tavolinat dhe karriget e arsimtarëve, tavolinat dhe stolat e laboratorëve, dërrasa e shkrimit, dollapët, varëset e rrobave, tabelat për njoftime.);
- (ii) **Pajisjet arsimore** siç janë lavamanët, njësitë fikse të murit, ventilatorët e avujve dhe tymit, veglat dhe pajisjet e laboratorit, kompjuterët dhe shtypësit...etj.);
- (iii) **Orenditë e hapësirave administrative**: tavolinat e punës, tavolinat, kolltukët, karriget, varësit special për harta dhe fotografi;
- (iv) **Pajisjet e hapësirave administrative**: kompjuterët, makina fotokopjuese, shtypësit, skanerët, pajisjet audiovizuale, telefonat...

3.7.1 ANTROPOMETRIA DHE DIMENSIONET E ORENDIVE

Orenditë dhe pajisjet shkollore duhet të përshtaten me numrin e nxënësve që i shfrytëzojnë ato. Qëndrimet jokorrekte për shkak ulëses ose tavolinës së papërshtatshme që është e vendosur shumë poshtë ose shumë lart mund të shkaktojë lodhje dhe probleme fizike. Ngjashëm, nxënësit nuk duhet të rrinë në maja të gishtave për ta mbërri dërrasën e shkrimit, e as nuk duhet të ulën në ulëse tepër të mëdha ose tepër të ngushta për ta.

Madhësia dhe dizajni i njësive të orendive dhe të pajisjeve zakonisht bazohet në kërkesat ergonomike vetë të definuara përmes matjes së fëmijëve të përfituara përmes anketave antropometrike. Për shembull, lartësia e këmbës më të ulëtë përdoret për të rregulluar lartësinë e ulëseve dhe distancën për mbërritjen e lartësisë së rafteve (shih fig. 1-3.10 dhe 3.11 më poshtë).




FIG. 1-3.10

Anketat antropometrike japin dimensionet e fëmijëve mesatarë, si dhe madhësitë maksimale dhe minimale për secilën grupmoshë dhe se projekti i orendive bazohet në këto dimensione. Për shembull, (i) për pozitën ulur, dimensionet e këmbës më të ulët, këmbës më të lartë, gjerësisë së vitheve dhe gjerësisë së krahërorit janë të nevojshme, dhe (ii) për sipërfaqet e punës (ulur), lartësia e bërrylit, trashësisë së kofshëve, lartësia e përkuljes përpara dhe e syve janë të nevojshme.

Dimensionet e fëmijëve dallojnë nga një vend në tjetrin, por deri më sot Kosova nuk ka realizuar asnjë anketë antropometrike specifike. Dimensionet aktuale të orendive shkollore bazohen në anketat e mëparshme dhe me gjasë në anketat e vendeve fqinje.

Për arsye praktike, madhësitë e nxënësve në mes të 6 dhe 18 vjeç shpesh ndahen në katër kategori që korrespondojnë me katër madhësi të orendive. Si rezultat, rezultatet e një ankete antropometrike në vitin 1998 nga UNESCO për shkollat e Palestinës janë të dhëna në ta-

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	70

MESATARJA E GJATËSISË SË NXËNËSVE

Ref.	Viti	Madhësia	Mesatarja e lartësisë (cm)		Niveli i Arsimit
	(Vitet)	Kategoria	Viti i parë	Viti i fundit	
A	6-8	I vogël	117	126	Fillor
B	9-10	Mesëm	137	137	Fillor
C	11-13	Madh	154	155	Mesme e ulët
D	14-18	Para-rritur	160	171	Mesme ulët/lartë

TABELA 3.7

REKOMANDIMET PËR ULËSET E NXËNËSVE

Ref.	Madhësia Kategoria	Lartësia	Gjerësia	Thellësia
A	I vogël	30.0	28.0	33.0
B	Mesëm	34.0	31.5	37.0
C	Madh	37.5	34.5	40.5
D	Para-rritur	38.0	38.0	44.5

TABELA 3.8

REKOMANDIMET PËR MADHËSINË E BANKAVE PËR NXËNËS

Ref.	Madhësia Kategoria	Lartësia	Bankat dyshe		Bankat njëshe	
			Gjerësia	thellësia	Gjerësia	Thellësia
A	I vogël	50.0	110.0	55.0	55.0	55.0
B	Mesëm	56.0	115.0	57.5	57.5	57.5
C	Madh	62.0	115.0	57.5	57.5	57.5
D	Para-rritur	68.0	120.0	60.0	60.0	60.0

TABELA 3.9





FIG. 1-3.11



Mësimi në grupe

Organizimi i dhomës së mësimit me një tavolinë për një nxënës
Niveli I Mesëm, 24 ose 36 nxënës, Orenditë e kategorisë 'C'

FIG.1-3.12

belën 3.7 më poshtë me mesataren e gjatësisë së nxënësve nëpër kategori, madhësia e rekomanduar për ulëset e nxënësve (tabela 3.8) dhe bankat e nxënësve (tabela 3.9)

MASHT rekomandon përdorimin e ISO-standardeve për projektimin e orendive shkollore.

3.7.2 HAPËSIRA NË RAPORT ME NDËRTIMIN

Ndërtesat duhet të projektohen asisoj që orenditë dhe pajisjet merren në konsideratë. Prandaj është qenësore që karakteristikat e tyre, sasia dhe dimensionet të defino-

hen qartë para fillimit të projektimit të ndërtesës. Në këtë pikë, janë me rëndësi kërkesat kryesore në raport me hapësirën që duhet të merren parasysh si nga projektuesit të ndërtesave, ashtu edhe ata të orendive:

- (i) Dimensionet e dhomave në përputhje me madhësinë, sasinë dhe karakteristikat e orendive dhe të pajisjeve: hapësirat nuk duhet të tejmbushen me orendi dhe dhomat duhet të jenë mjaft të mëdha për të pasur vend për artikujt e kërkuar;
- (ii) Dimensionet e orendive dhe të pajisjeve duhet të jenë kompatible me dimensionet e dyerve, korridoreve dhe shkallëve, ashtu që transporti, sjellja dhe insta-

Niveli	Tema	Faqe
GJN	REF	72

- limi të mund të realizohen lehtë;
- (iii) Mbrojtësit metalikë të orendive duhet të mbrohen, për të mbrojtur skajet e dyshemeve;
- (iv) Pikat e përplasjes ndërmjet elementeve të orendive dhe të ndërtesës, siç janë muret dhe këndet e ekspozuara duhet të mbrohen, sidomos kur përdoren karrocet për bartje;
- (v) Sa është e mundur, orenditë duhet të prodhohen nga materiali rezistent ndaj zjarrit. Kjo masë i plotëson masat për mbrojtje nga zjarri të përshkruara në paragrafin 2.5.3 më lart.

Kërkesat e tjera të hapësirës në raport me elementet tjera duhet të kihen parasysh për ujin, dhe furnizimin me rrymë elektrike, rrjetin e kanalizimit dhe të kullimit, si dhe rrjetin e kompjuterëve. Projekti i këtyre rrjeteve duhet të ketë parasysh karakteristikat e kërkuara (lokacionin, diametrat, voltazhin, intensitetin, prizat dhe spinat ...) sidomos nëpër laboratorë, salla të posaçme për mësimdhënie, zyra administrative aty ku mund të instalo-hen pajisje të rënda.

3.8 KËRKESAT E POSAÇME

3.8.1 PROJEKTIMI PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Projektimi/dizajnimi i ndërtesave shkollore duhet të siguroj qasjen e papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe mësim-nxënies të nxënësve me nevoja të veçanta. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me 18.06.2007 ka aprovuar Udhëzimin Administrativ për "Kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", prandaj, projektuesit duhen të bazohen në këtë udhëzim por edhe në këtë udhëzues do të përmbli-dhen kushtet teknike më specifike për ndërtesat shkollore. Llojet e nevoja të veçanta për të cilat mund të përkujde-semi në një shkollë standarde do të kufizohen, për arsye praktike, në ato me nevoja të veçanta në lëvizje, humbje

të dëgjimit që korrigjohet me pajimet për dëgjim, dhe humbja e pjesërishme ose e tërësishme e të pamurit, pas trajnimit adekuat. Mirëpo, kategoria e fundit nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkollore të mësimdhënies ose të mësimnxënies.

Personat me nevoja të veçanta mund të jenë nxënës, arsimtarë, mysafirë ose personel. Problemi i tyre krye-sore është reduktura në lëvizshmërinë e tyre për arsye se ata shfrytëzojnë karrocet e invalidëve, patericat ose bastunët. Ky problem kërkon dimensionim të veçantë të zonave të qarkullimit, hapësirave të dyerve, pajisjeve sanitare, shtigjeve të evakuimit dhe hapësirave të klasave për t'i akomoduar personat me nevoja të veçanta.

